

VENDIM
Nr. 736, datë 13.12.2023

PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR SHTETIN E SË DREJTËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, si dokument i politikave shtetërore, piketa hapëse të grup-kapitullit të parë “Themeloret”, në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme marrin masat për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij udhërrëfyesi.
 3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe të gjitha institucionet që kanë në përgjegjësi masat e përfshira në udhërrëfyes për zbatimin e tyre.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

FUSHAT DHE NËNFUSHAT	KUADRI STRATEGJIK/LEGJISLATIV/ INSTITUCIONAL	KAPACITETI ZBATUES DHE INSTITUCIONAL	PERFORMANCA
KAPITULLI 23. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE 16			
I. REFORMA NË DREJTËSI			
REFORMA NË DREJTËSI	Konsolidimi i arritjeve të reformës Shqipëria konsolidon arritjet e reformës në fushën e gjyqësorit në mënyrë të qëndrueshme dhe konsistente, me synimin për të rritur më tej pavarësinë, llogaridhënien, cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë. Kryerja e kontrolleve të rregullta të përshtatshmërisë ligjore dhe miratimi i ndryshimeve ligjore të nevojshme për konsolidimin, pavarësinë, integritetin, efikasitetin dhe rritjen e besimit të publikut, në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së dhe standardet evropiane dhe përf forcim i mëtejshëm i parimeve të reformës në drejtësi të vitit 2016. Shqipëria vijon edhe më tej finalizimin progresiv të reformës brenda vitit 2026, përfshirë nëpërmjet ndryshimeve ligjore: - Sigurimin e pakthyeshmërisë së rezultateve pozitive të procesit të rivlerësimit, duke përf orcuar normat për kontrollin e pasurive dhe figurës për aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë; - Masave që sigurojnë efikasitet; - Zbatimit dhe forcimit të dispozitave që rregullojnë parapërzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së dhe institucioneve të tjera vetëqeverisëse, të cilat do të jenë në përputhje me standardet e kontrollit të figurës dhe të deklarimit të pasurisë të zbatueshme për magjistratët; - Ndalimit të përfshirjes së ish-magjistratëve të shkarkuar/dorëhequr gjatë procesit të rivlerësimit në veprimtaritë e institucioneve të qeverisjes së drejtësisë; - Forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës.	Ruajtja dhe shtimi i burimeve të përshtatshme, infrastrukturës gjyqësore dhe niveleve të personelit, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë te gjykatat, për të bërë të mundur avancimin e objektivave të reformës brenda vitit 2030, duke përfshirë një qasje me objektiv rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor. Rritje e mëtejshme e kapaciteteve të organeve të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar në mënyrë që të mund të kryejnë në mënyrë efektive hetimin dhe gjykimin.	Avancimi i reformës në drejtësi, përfshirë zbatimin e kuadrit ligjor të reformës në drejtësi, kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, në përputhje me standardet evropiane, deri në vitin 2030. Përmirësohet dhënia e efikase të drejtësisë, ndër të tjera, nëpërmjet uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata, metodologjisë së përmirësuar në menaxhimin e gjykatave, përmirësimin e performancës të të dy Këshillave në funksion të karrierës gjyqësore dhe cilësisë së drejtësisë, përmirësimit të cilësisë së trajnimit mbi metodat që lidhen me menaxhimin e kohës së gjykatës, zbardhjen e vendimeve dhe aplikimin e standardeve më të mira të BE-së në dhënien e drejtësisë. Ekzekutim i vendimeve të GJEDNJ-së, veçanërisht në lidhje me të drejtën për procesin e rregullt ligjor.
	Finalizimi i procesit të rivlerësimit nën monitorimin e pavarur ndërkombëtar dhe qëndrueshmëria e rezultateve të procesit të rivlerësimit për magjistratët gjatë gjithë karrierës së tyre.		
		Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioneri Publik sigurojnë përfundimin e të gjitha çështjeve të rivlerësimit në pritje për gjykim deri në vitin 2024. Kolegji i Posaçëm i Apelit përshpejton ritmin në gjykimin e ankimeve dhe ndërmerr të gjithë	Procesi i rivlerësimit përfundon brenda afatit kushtetues, duke ruajtur standardet e larta të cilësisë dhe tërësinë/gjithëpërfshirjen e hetimeve. Ndjekje efektive gjyqësore për çështjet e procesit të rivlerësimit ku ka dyshime për elementë kriminalë të referuara në prokurori. Standardet e procesit të rivlerësimit mbeten në fuqi nga institucionet

	hapat përkatës për të siguruar përfundimin e çështjeve, dhe përmbush në mënyrë sistematike rezultatet e parashikuara nga ana e tij brenda afatit kushtetues. Institucionet e rivlerësimit sigurojnë referimin sistematik në prokurori të çështjeve ku ka dyshime për elementë kriminalë. Shërbimet e prokurorisë iniciojnë në mënyrë proaktive procedime penale ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, procesi i rivlerësimit të të cilëve ka gjetur elementë kriminalë. Mbajtja e burimeve njerëzore të kualifikuara të zhvilluara nga institucionet e rivlerësimit pas vitit 2024 e në vazhdim. Sigurimi që të gjitha institucionet shtetërore dhe autoritetet gjyqësore, përfshirë KLP-në dhe KLGJ-në, të respektojnë pavarësinë dhe juridiksionin ekskluziv të organeve të rivlerësimit dhe të sigurojnë që vendimet të jenë në përputhje me vendimet e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Sigurimi që pas përfundimit të procesit të rivlerësimit, të mbetet në fuqi një sistem kontrollësh të plota të integritetit si mekanizëm standard për të garantuar integritetin maksimal të magjistratëve gjatë gjithë karrierës së tyre.	qeverisëse, duke siguruar qëndrueshmëri dhe konsistencë të standardeve të procesit të rivlerësimit gjatë kontrollit të integritetit dhe figurës. Demonstrimi i një sistemi historiku sistematik llogaridhënie dhe integriteti në sistemin gjyqësor në të gjitha nivelet pas procesit të rivlerësimit.
Mbajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve, pavarësisë dhe efikasitetit të organeve qeverisëse		
KLP-në miraton legjislacionin e nevojshëm nënligjor për të përfunduar procesin e vlerësimit të prokurorëve (KLP-ja miraton rregulloren e vlerësimit për PP dhe rregulloren për drejtuesit e prokurorëve). Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të përafrojë plotësisht procedurat e tij me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe të rrisë transparencën.	Organet e qeverisjes së drejtësisë të përfshira në <i>vetting</i> të anëtarëve të Këshillave ose të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veçanërisht anëtarëve jo magjistratë: - ndërmarrin masa të rregullta për ngritjen e kapaciteteve për rritjen e kapaciteteve për kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit; - kryejnë kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit në përputhje me standardet e larta të procesit të rivlerësimit. Sigurohet cilësia e vendimeve të KLGJ-së dhe KLP-së, përfshirë përputhshmërinë me legjislacionin e brendshëm, <i>acquis</i> të BE-së dhe standardet evropiane, përmes trajnimeve të organizuara nga viti 2024 e në vijim. Përcaktohen mekanizma që nxisin meritokracinë	Sigurohen në praktikë dhe në kohë kontrollet e figurës dhe të pasurisë/integritetit të kryera në përputhje me standardet e procesit të rivlerësimit, siç parashikohet me ligj nga KLGJ-ja, KLP-ja, KED-ja, organet përgjegjëse për <i>vettingun</i> e zyrtarëve të tjerë të drejtësisë dhe emërimet e përgjithshme të bazuara në meritokraci, deri në vitin 2027. Forcohet kapaciteti, pavarësia dhe efikasiteti i organeve të pavarura të vetëqeverisjes së gjyqësorit. Sigurohet cilësia e vendimeve të KLGJ-së dhe të KLP-së.

		dhe mbrojtjen nga ndikimi politik, edhe për anëtarët jomagjistratë të organeve të qeverisjes së drejtësisë. KL.GJ-ja zbaton për më shumë edhe një program transparence dhe komunikimi për të gjithë elementët e vendimmarrjes së saj, duke përfshirë vendimet në lidhje me karrierën, menaxhimin, rekrutimin e stafit, funksionimin e gjykatave dhe monitoron dhe raporton në mënyrë publike vazhdimisht zbatimin e tij. KLP-ja miraton dhe zbaton një program transparence dhe komunikimi për të gjithë elementët e vendimmarrjes së saj, duke përfshirë vendimet në lidhje me karrierën, menaxhimin, rekrutimin e stafit, funksionimin e gjykatës dhe monitoron dhe raporton në mënyrë publike vazhdimisht zbatimin e tij.	
Thellimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional përmes një kuadri solid strategjik			
Konsolidimi i zbatimit të reformës nëpërmjet Strategjisë së rishikuar të Drejtësisë 2024–2030, duke bërë të mundur rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, monitorimin e rregullt dhe përmirësimin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.	Kapacitete të përshtatshme të institucioneve të drejtësisë për të siguruar bashkëpunimin e duhur, si dhe mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin për avancimin e reformës në drejtësi deri në vitin 2026. Rritet bashkëpunimi i Këshillave, duke intensifikuar mbledhjet e përbashkëta dhe sigurimin e komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun për ndjekjen e konkluzioneve të mbledhjeve.	Vijimi i zbatimit të mirë të reformës në drejtësi për të garantuar funksionimin sistematik të sektorit të drejtësisë përmes zgjerimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe forcimit të monitorimit deri në vitin 2030.	
Rritja e komunikimit publik të reformës dhe institucioneve të drejtësisë			
Plane komunikimi dhe transparence të hartuara nga KL.GJ-ja, KLP-ja, SPAK-u dhe MD-ja, për të zhvilluar më tej mirëkuptimin dhe rritjen e besimit të publikut në reformën në drejtësi dhe kuadrin dhe vendimmarrjen institucionale nga viti 2024.	Kapacitete të qëndrueshme të institucioneve të drejtësisë, veçanërisht KL.GJ-ja, KLP-ja, MD-ja, SPAK-u dhe PP-ja për të hartuar dhe zbatuar komunikimin dhe transparencën mbi zhvillimet në sistemin e drejtësisë nga viti 2026.	Mbajtja/ruajtja e një komunikimi dhe transparence të vazhdueshme, përfshirë mbajtjen e qytetarëve të mirinformuar mbi zhvillimet në shërbimet e drejtësisë për reformën në drejtësi, nga viti 2030.	
I.B PAVARËSIA DHE PAANËSIA			
Vijim i emërimeve të bazuara në meritokraci dhe sistemi i avancimit në karrierë	Shih ndryshimet ligjore më sipër nën 1. Konsolidimi i arritjeve të reformës	Këshillat rishikojnë rregulloret e tyre të brendshme dhe bëjnë përpjekje që deri në fund të vitit 2025 të kryejnë: - Kontroll rigoroz dhe në kohë të pasurive dhe figurës bazuar në standardet e zhvilluara nga procesi i rivlerësimit, përpara ngritjes në detyrë; - Ulje e ndjeshme e numrit të mbetur të vlerësimeve, duke arritur të paktën 60% të parashikimeve vjetore të planifikuara deri në vitin 2025 dhe 100% deri në vitin 2030, në	Vendimet për zhvillimin e karrierës bazohen vazhdimisht në meritokraci dhe në vijim të kontrollit të pasurisë dhe figurës të barabartë me standardet e procesit të rivlerësimit deri në vitin 2030.

		përputhje me dispozitat ligjore dhe praktikat më të mira të BE-së. Deri në vitin 2030, të paktën 80% e gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistem duhet të jenë vlerësuar të paktën një herë; - Aplikimin e kontroleve tërësore të magistratëve përpara futjes në sistemin e karrierës; - Kontrollat periodike të integritetit janë të lidhura me ngritjen në detyrë. KLJG-ja dhe KLP-ja sigurojnë më tej promovimin transparent të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke publikuar rregullisht të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë.	
Rezistencë ndaj ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme		Trajnime për forcimin e integritetit të ofruara nga Shkolla e Magistraturës dhe institucionet qeverisëse që nga viti 2024. Këshillat reagojnë ndaj deklaratave publike ku ushtrohet ndikim i padrejtë mbi magistratët dhe marrin masa parandaluese, deri në vitin 2024. Penalizim i presionit dhe kërcënimeve politike, duke përfshirë akuzat kundër magistratëve. Këshillat kryejnë monitorim të vazhdueshëm për monitorimin e çështjeve gjyqësore penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në gjyqësor.	Qëndrueshmëria e mirë kundrejt presioneve të brendshme dhe të jashtme përforcohet gradualisht dhe vazhdimisht deri në vitin 2030.
Qëndrueshmëria e shpërndarjes së rastësishme të çështjeve	KLJG-ja kryen një analizë për ngritjen e sistemit të paralajmërimit të hershëm të monitorimit të shpërndarjes së çështjeve nga gjykatat për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të shpërndarjes së rastësishme të çështjeve dhe masa korrigjuese të duhura kur është e nevojshme.	KLJG-ja dhe PP-ja sigurojnë që rregulloret për shpërndarjen e rastësishme të çështjeve zbatohen në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme në gjykata dhe prokurori bazuar në kritere transparente dhe të rregullta nga viti 2024 e në vijim.	Pavarësia dhe paanshmëria brenda proceseve gjyqësore forcohet përmes kontroleve të vazhdueshme të përshtatshmërisë të kryera për funksionimin e duhur të shpërndarjes së rastësishme të çështjeve në përputhje të plotë me standardet evropiane deri në vitin 2025.
I.C LLOGARIDHËNIA			
Deklarata e pasurisë		ILDKPKI-ja siguron përditësime të vazhdueshme dhe konsistente të deklaratave të pasurisë së anëtarëve të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë dhe heton dhe raporton rastet në prokurori, sipas rastit, bazuar në praktikën e vendosur nga standardet e larta të procesit të rivlerësimit.	Deklaratat e pasurisë së anëtarëve të institucioneve të pavarura të drejtësisë përditësohen dhe verifikohen në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2024 e në vazhdim.

		KL.GJ-ja dhe KLP-ja sigurojnë ndjekjen sistematike të raporteve të ILDKPKI-së mbi deklarin e pasurisë dhe sipas rastit, hetime të mëtejshme në kontekstin e shqyrtimit të pasurisë dhe të figurës, duke përfshirë sigurimin e hetimeve vijuese efektive dhe referimin në prokurori.	
Historik sistematik i llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet e gjyqësorit	Në kuadrin e ndryshimeve ligjore të planifikuara, Shqipëria do të sigurohet që rregullat për përbërjen dhe vjetërsinë në detyrë të ILD të përcaktojnë garanci të kënaqshme për paanshmërinë, pavarësinë dhe profesionalizmin për të mbrojtur organin nga ndikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i legjislativit dhe ekzekutivit.	Pozicionet e inspektorëve në ILD të plotësohen gradualisht deri në vitin 2026, me objektiva, për të siguruar bërjen më tërheqës të pozicionit. Stafi mbështetës i ILD-së është konsoliduar dhe i përgjigjet nevojave objektive të institucionit. Sigurohen burime të qëndrueshme dhe të përshtatshme të akorduara nga KLP-ja dhe KLP-ja për kryerjen në kohë dhe në mënyrë sistematike të procedimeve disiplinore të nisura nga ILD-ja deri në vitin 2025 e në vazhdim. Duhet të përcaktohen rregullat të zbatueshme për monitorimin periodik të telekomunikacionit të personelit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsion dhe Krim të Organizuar për ta bërë sistemin funksional në përputhje me parimet e proporcionalitetit, qartësisë dhe parashikimit. Sistemi zbatohet në përputhje me standardet evropiane. Zbatimi dhe ndjekja e mëtejshme e dokumenteve strategjike të KL.GJ-së për hetimin administrativ të sinjalizuesve dhe shqyrtimin e rasteve të korrupsionit brenda KL.GJ-së.	Shërbimet e inspektimit dhe institucionet vetëqeverisëse, veçanërisht KLP dhe KL.GJ bëjnë të mundur vazhdimisht zhvillimin në kohë dhe të qëndrueshëm të historikut të llogaridhënies dhe integritetit në sistemin gjyqësor në të gjitha nivelet.
I.D. CILËSIA E DREJTËSISË			
Cilësia e drejtësisë	Mbajtja e një baze të mirë për mbështetjen e sistemit të drejtësisë		
		Qeveria/Kuvendi siguron vazhdimin e nivelit të duhur të akordimit të burimeve për institucionet e sistemit të drejtësisë. Përmirësim gradual i infrastrukturës gjyqësore, duke përfshirë ambiente të përshtatshme për gjykatën e apelit deri në vitin 2027.	Institucionet e drejtësisë konsolidojnë gradualisht funksionimin e tyre, duke çuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve gjyqësore deri në vitin 2030. Plotësohen 80% e vendeve vakante për magjistratë, të paktën deri në vitin 2030.
	Përmirësimi i performancës së magjistratëve dhe gjykatave dhe prokurorive		
	Këshillat avancojnë miratimin e akteve nënligjore të mbetura të vlerësimit të performancës brenda vitit 2025.	KLP-ja dhe KL.GJ-ja kryejnë trajnime në vend të anëtarëve dhe stafit të përfshirë në vlerësimin e performancës.	Përmirësohet vlerësimi i performancës nga Këshillat dhe është vendosur fokus shtesë në cilësinë e ofrimit të shërbimit të drejtësisë deri në vitin 2030. Performanca e gjykatave dhe prokurorive përmirësohet gradualisht dhe

	Këshillat rishikojnë metodologjitë e tyre për vlerësimin e performancës brenda vitit 2025 për të arritur një balancë më të madhe ndërmjet kriterëve cilësorë dhe sasiorë dhe rritjen e transparencës së procesit, dhe zbatojnë metodologjinë.	Rritja e performancës së gjykatave dhe prokurorive deri në vitin 2030 nëpërmjet: - Miratimit të Rregulloreve të Brendshme për cilësinë e drejtësisë, duke filluar nga viti 2024 deri në vitin 2027; - Zbatimi i rekomandimeve të inspektimeve të rregullta tematike nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë; - Zbatimi i gjetjeve të anketave të kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës të kryera nga KLGJ në baza periodike.	promovon shërbime cilësore të drejtësisë, duke përfshirë kohë më të shkurtra të vendimmarrjes dhe rritjen e kapaciteteve funksionale deri në vitin 2030.
Forcimi i kapaciteteve të trajnimit gjyqësor			
	SHM-ja ndryshon Rregulloren e saj të Brendshme për të siguruar që provimi i pranimit të pasqyrojë standardet më të mira të BE-së dhe të plotësojë pranimet bazuar në njohuri dhe në kapacitete, deri në vitin 2024. SHM-ja rishikon programin e saj të trajnimit fillestar dhe metodologjinë e programit të trajnimit të vazhdueshëm në mënyrë që të reflektojë standardet më të mira të BE-së, për të vënë më shumë theksin në praktikë, për të gjykuar aftësitë e profesionit, etikën dhe integritetin dhe për të konsoliduar programin e këshillimit deri në vitin 2025.	SHM-ja siguron staf dhe burime të duhura në bazë të analizave, shqyrtimit dhe parashikimit të nevojave për burime njerëzore dhe akademike deri në vitin 2030, që nga 2024 Provimi i pranimit kryhet bazuar në metodologjinë e rishikuar në përputhje me praktikatat më të mira të BE-së dhe përfshin provimin e bazuar në aftësi nga viti 2024 e tutje. Programi i konsoliduar dhe i përmirësuar i këshilltarëve zbatohet nga SHM/gjykatat nga viti 2025 e në vazhdim. Miratohet dhe zbatohet kurrikula e rishikuar e trajnimit fillestar nga viti akademik 2025 e në vazhdim. Miratohet dhe zbatohet programi i pasuruar dhe përmirësuar i trajnimit të vazhdueshëm që ka objektiv nevojat e identifikuar dhe specializimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për magjistratët në detyrë nga 2025 e në vazhdim.	Trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm i pasuruar dhe rishikuar i magjistratëve siguron burime njerëzore kyçe, të përmirësuara dhe cilësore të gjyqësorit dhe prokurorisë deri në vitin 2030. Konsolidimi i kapaciteteve, cilësisë dhe efikasitetit të Shkollës së Magjistraturës. Burime të mjaftueshme dhe trajnim cilësor të stafit të SHM-së, i përbërë kryesisht nga profesionistë të drejtësisë. Trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm mbi profesionin e gjyqtarit, aftësitë gjyqësore, etikën dhe integritetin.
Rritja e pasjes në dispozicion dhe konsistencës së praktikës gjyqësore dhe cilësisë së arsyetimit			
		KLGJ-ja siguron publikimin dhe përmirëson hulumtimin e vendimeve gjyqësore deri në 2025/2026, veçanërisht të GJL-së. SHM-ja ofron trajnime për hulumtimin dhe analizën e çështjeve gjyqësore brenda vitit 2025. GJL-ja vijon të unifikojë vendimet e gjykatave dhe si rrjedhojë rritet më tej përmirësimi i praktikës gjyqësore. Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KLGJ-ja dhe KLP-ja përfshin, ndër të tjera, standardet e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.	Rritje graduale e qëndrueshmërisë së praktikës gjyqësore deri në vitin 2030. Publikimi i vendimeve të gjykatave në nivel apeli dhe Gjykata e Lartë, përfshirë gjykatat e SPAK-ut, në mënyrë lehtësisht të arritshëm/aksesueshëm përpara vitit 2027. Publikimi i vendimeve gjyqësore në të gjitha nivelet në mënyrë lehtësisht të arritshëm/aksesueshëm përpara vitit 2030.

		Sigurohet monitorim dhe vlerësim transparent i aktiviteteve të gjykatës. Merren masa për të siguruar që vendimet e gjykatave të jenë në dispozicion për publikun dhe lehtësisht të arritshëm, deri në vitin 2030.	
I.E. EFIKASITETI			
Qasje strategjike e përmirësuar për të rritur efikasitetin	Analizë e plotë e kryer nga KLGJ-ja dhe PP/SPAK-u për përmirësimin e ligjeve procedurale për përfitime të mëtejshme efikasiteti përmes ndryshimeve në ligjin procedural deri në vitin 2024. KLGJ-ja/këshillat e gjykatave dhe PP-ja hartojnë dhe miratojnë strategji efikasiteti/uljen e numrit të çështjeve të prapambetura/ shpërndarje të barabartë të ngarkesës së punës për gjykatat dhe prokuroritë në të gjitha nivelet brenda vitit 2024, dhe zbatimin e masave zbatuese nga viti 2025 e në vijim, duke përfshirë në veçanti: - Masa organizative dhe administrative; - Administrimin e gjyqeve dhe uljen e numrit të seancave për çështje; - Automatizimin përmes mbështetjes nga IT-ja; - Standardizimin e proceseve dhe vendimmarrjes; - Përdorimin sa më të mirë të personelit jo-magjistrat; - Performancën e gjykatës, si dhe cilësinë, riorganizimin dhe thjeshtimin e procedurave gjyqësore; - Zbatimin më efektiv të rregullave për disiplinën e gjykitimit dhe afatet procedurale; - Zbatimin në mënyrën e duhur të strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura për të siguruar rishpërndarjen e ngarkesës së punës ndërmjet gjyqtarëve dhe gjykatave; - Rritjen e kapaciteteve të jo gjyqtarëve dhe personelit administrativ për të përmbushur detyra specifike, duke marrë parasysh praktikatat më të mira të BE-së në këtë drejtim.	Burime njerëzore dhe buxhet i përshtatshëm për të siguruar zbatimin praktik të strategjisë së efikasitetit/uljes së numrit të çështjeve të prapambetura/shpërndarjes së ngarkesës së punës nga 2024. KLGJ-ja dhe KLP-ja avancojnë me emërimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve në të gjitha nivelet. Këshillat zgjerojnë më tej procedurat e vlerësimit dhe ngritjes në detyrë të magjistratëve bazuar në kriteret cilësorë dhe sasiorë dhe rrisin transparencën e procesit. Sigurohet ekzekutimi në kohë dhe efektiv i vendimeve gjyqësore të formës së prerë.	Kuadri i përgjithshëm ligjor dhe institucional dhe kapaciteti për të siguruar uljen graduale të numrit të çështjeve të prapambetura dhe kohëzgjatjen e arsyeshme të proceseve dhe periudha vendimmarrëse përmirësohen deri në vitin 2030. Ulet gradualisht periudha mesatare e vendimmarrjes, veçanërisht në nivel apelit.
Përmirësimi i përdorimit më tërheqës të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve		Dhoma e Ndërmjetësuesve vijon të konsolidojë sistemin e ndërmjetësimit nëpërmjet: - Vazhdimin e ofrimit të trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për ndërmjetësuesit, kandidatë dhe të akredituar; - Ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjëse për ndërmjetësimin;	Mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve janë gjithnjë e më në dispozicion dhe mundësia e përdorimit të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve u komunikohet vazhdimisht palëve nga gjykatat që nga viti 2025 e në vazhdim.

		- Rritjen e numrit të ndërmjetësuesve. Detyrimi ligjor nga gjykatat për të informuar siç duhet palët për mundësinë e përdorimit të ndërmjetësimit është: - E konsideruar nga KL.GJ në vlerësimin e performancës; - Vlerësuar nga ILD në kuadër të inspektimeve tematike.	
Mbështetje e efikasitetit nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	Ngritjen e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve (ICMIS), duke përfshirë hartimin e të gjitha proceseve, detaje të funksioneve, të përfunduar nga Bordi i Qendrës së TI-së brenda vitit 2024. Bordi i Qendrës IT miraton planin strategjik për zbatimin e sistemit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë ndërveprimin në sistemin e drejtësisë, përfshirë prokurorinë, gjykatat dhe institucionet e tjera të drejtësisë, brenda vitit 2024.	Sigurohen burimet e duhura njerëzore dhe mbështetja buxhetore për ngritjen e sistemit ICMIS që garanton ndërlidhje të sigurt me bazat e të dhënave dhe sistemet përkatëse dhe ndërveprim nga viti 2024 e tutje bazuar në parashikimet vjetore. Qendra IT siguron koordinimin e duhur në zbatimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, duke siguruar ndërveprim, deri në vitin 2025. Qendra IT është e pajisur me burimet e nevojshme njerëzore dhe gëzon kompetenca ekzekutive për të funksionuar në mënyrë efektive. Ofrohet trajnim për funksionet dhe përdorimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve, brenda vitit 2025.	Efikasiteti rritet vazhdimisht përmes zbatimit të duhur të sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve të bazuar në parimin e ndërveprimit deri në vitin 2027. Mbledhja, publikimi dhe raportimi i të dhënave statistikore gjyqësore janë përmirësuar dhe përdoren për efikasitetin në menaxhim apo burime, në veçanti për shpërndarjen e ngarkesës së punës. Rritje e bashkëpunimit dhe e komunikimit ndërmjet gjykatave dhe palëve të tjerë në proces si avokatët, prokurorët, noterët, ndërmjetësuesit dhe përmbaruesit, të përmirësuar nga ICMIS-ja.
II. LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT			
II.1. Kuadri i përgjithshëm	Përmirësohet më tej kuadri strategjik dhe ligjor për antikorrupsionin		
Ekziston një kuadër i konsoliduar ligjor dhe politikash kundër korrupsionit dhe që është në gjendje të trajtojë në mënyrë efektive korrupsionin në të gjitha nivelet, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Sigurohet monitorimi, vlerësimi dhe koordinimi. ILDKPKI-ja duhet të vazhdojë të përmirësojë kapacitetet e saj për të kryer verifikimin efikas të deklaratave të pasurisë dhe interesave private, si dhe duhet të sigurohen burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.	Mbajtja në mënyrë të qëndrueshme e të dhënave të trajtimit të masave të lidhura me integritetin dhe kundër korrupsionit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nëpërmjet miratimit të Strategjisë Ndërsëktoriale Antikorrupsion 2024–2030, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Trajtimin në baza që qëndrueshme dhe logjike, siç përcaktohen në Strategji, të çështjeve që lidhen me integritetin në sektorët e cënueshëm ndaj korrupsionit, si pronat, shëndetësia, arsimi, prokurimi publik dhe PPP-të, taksat dhe doganat, nga viti 2024 e në vazhdim. Sigurimi i harmonizimit të mëtejshëm me <i>acquis</i> të BE-së dhe Standardet e BE-së, për	Sigurimi i kapaciteteve të përshtatshme të institucioneve përgjegjëse në kuadër të strategjisë për monitorim dhe vlerësim, në mënyrë që të përballen me nevojën për të trajtuar treguesit e performancës të përcaktuar në Strategji bazuar në parashikimet vjetore që nga viti 2025 e në vazhdim, me objektiv të veçantë treguesit e sektorëve veçanërisht të prekshëm nga korrupsioni. Aktivitetet të përshtatshme, me qëllim ndërgjegjësimin, të realizuara në kuadër të strategjisë ndaj institucioneve të administratës publike nga viti 2024 e në vazhdim.	Zbatimi i qëndrueshëm dhe zbatimi efikas i kuadrit të rishikuar strategjik dhe ligjor për korrupsionin i bërë i mundur deri në vitin 2027, në përputhje të plotë me standardet e BE-së. Uljën e incidencës së korrupsionit. Rreziku i korrupsionit trajtohet vazhdimisht, veçanërisht në sektorët e cënueshëm ndaj korrupsionit, dhe matet përmes objektivave të treguesve të performancës të strategjisë së re antikorrupsion çdo vit deri në vitin 2030. Objektivat ndërgjegjëses të strategjisë të zbatuara vazhdimisht, me fokus të veçantë ndërgjegjësimin, brenda institucioneve të administratës publike, që nga viti 2025 e në vazhdim. Sigurohet ndjekja e duhur dhe ruhet qëndrueshmëria në procesin e zbatimit të procesit të deklarimit të pasurisë nga viti 2025 e në vazhdim. .

	antikorrupsionin, si dhe ulja i kompleksitetit të legjislacionit në fushën e antikorrupsionit, duke ndërmarrë masa legjislative për të miratuar: - Ligjin për Konfliktin e Interesit i miratuar deri në vitin 2025; - Ligjin për lobimet të miratuar deri në vitin 2027; - Ligjin për financimin e partive politike të miratuar deri në vitin 2027; - Ratifikimin e Konventës për Luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve publikë të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar deri në vitin 2027; - Ndryshime të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve deri në vitin 2025. Çdo ndryshim i planifikuar legjislacionit penal do të jetë në përputhje me <i>acquis</i> e BE dhe standardet ndërkombëtare dhe në përputhje me planin e vendit, në kuadër të reduktimit konsistent të korrupsionit. Kontrolle të rregullta të përshtatshmërisë për konsolidimin, harmonizimin e legjislacionit në fushën e antikorrupsionit, në përputhje me standardet e BE-së që nga viti 2025 e në vazhdim, duke përfshirë rishikimin e kuadrit ligjor për kompetencat ekzekutive të SPAK-ut. Analiza mbi kuadrin ligjor për donacionet dhe sponsorizimet të kryhet deri në vitin 2025 dhe legjislacioni të rishikohet brenda vitit 2027. Rishikimi i procedurave të kontroleve të kryera nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit deri në vitin 2025 për të siguruar një format përfaqësues të kontratave shtetërore, të ndjekur nga përputhshmëria nga autoritetet përkatëse dhe monitorim nga Kuvendi.	Forcimi i rrjetit të komunikimit me OJF-të kundër korrupsionit nga viti 2024 e në vazhdim. Sigurimin e burimeve të qëndrueshme të duhura për ILDKPKI-në, duke përfshirë kapacitetin e tij në zbatimin e ligjit për sinjalizuesin dhe kapacitetin e tij për të kryer verifikimin efikas të deklaratave të pasurisë që nga viti 2025 e në vazhdim.	Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja e shtuar e shoqërisë civile në procesin e politikëbërjes dhe monitorimit të bërë të mundur përmes masave përkatëse menaxhuese strategjike deri në vitin 2025.
	Sigurimi i legjislacionit të harmonizuar dhe koordinim ndërinstitucional për antikorrupsionin Koordinim i zgjeruar mes organeve përkatëse qeveritare dhe institucioneve të tjera përkatëse të trajtuara përmes objektivave të Strategjisë Ndërsëktoriale Antikorrupsion 2024–2030.	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe Drejtoria e Përgjithshme kundër Korrupsionit bashkëpunojnë përmes Memorandumit të Mirëkuptimit ku përcaktohet bashkëpunimi në raportimin e rasteve të korrupsionit deri në vitin 2024. Zyrtarizmi i bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit dhe prokurorive deri në vitin 2024.	Përmirësohet në mënyrë progresive bashkëpunimi ndërinstitucional midis agjencive shtetërore dhe shërbimeve të prokurorisë deri në vitin 2024 e në vazhdim, me qëllim rritjen e koherencës së qenësishme të kuadrit institucional të ngarkuar me politikëbërjen dhe hetimin e rasteve të korrupsionit.
II.2. Parandalimi	Trajtimi në mënyrë tërthore i parandalimi të korrupsionit në sektorët e prekshëm nga korrupsioni		

	Vlerësimi i rrezikut sektorial dhe plani për zbutjen e rrezikut ndaj integritetit dhe korrupsionit në sektorët e prekshëm ndaj korrupsionit (pronat, shëndetësia, arsimi, prokurim publik dhe PPP, taksa dhe dogana), i miratuar deri në vitin 2025.	Ruajtja e konsistencës në konsolidimin e burimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe institucioneve përkatëse për të analizuar, vlerësuar në mënyrë të përshtatshme korrupsionin në sektorët me rrezik dhe zbatimin e masave zbutëse për fushat e prekshme nga korrupsioni, duke përfshirë pronat, shëndetësinë, arsimin, prokurimin publik, PPP-të, taksat dhe doganat, deri në vitin 2027. Vijimi i bashkëpunimit të vazhdueshëm me shoqërinë civile në kryerjen e vlerësimeve të rrezikut ndaj integritetit në institucionet shqiptare në baza të rregullta. Mbrojtje nga korrupsioni i legjislacionit nga Kuvendi që nga viti 2027 e në vazhdim. Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik, duke përfshirë futjen e flamujve të kuq, evidentimin e parregullsive të mundshme, duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim. Përgatitja e dispozitave të integritetit në lidhje me prokurimin publik për t'u përfshirë në planet e integritetit të autoriteteve kontraktuese, duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.	Ulje e rrezikut të korrupsionit në përgjithësi, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në sektorët më të prekshëm, si pronat, shëndetësia, arsimi, PPP-të e prokurimi publik, taksat dhe doganat) deri në vitin 2030, nëpërmjet zbatimit të masave me objektiv zbutjen e rrezikut çdo vit. Rezistenca më e madhe ndaj kërcënimeve të integritetit në sektorin e prokurimeve rritet në mënyrë të qëndrueshme përmes procedurave dhe proceseve ligjore të qarta dhe transparente.
	Ruajta e progresit në zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s		
	Rishikim i legjislacionit kundër korrupsionit, me qëllim rritjen e koherencës themelore të kuadrit ligjor në këtë fushë, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në legjislacionin për konfliktin e interesit brenda vitit 2025. Sigurimi i hartimit të kuadrit ligjor të rishikuar dhe rregulloreve në një manual dhe ofrimi i udhëzimeve për detyrimet e secilës kategori dhe për rolin e secilit organ përgjegjës, sipas rekomandimeve të GRECO, brenda vitit 2024. Përcaktimi i rregullave për angazhimin e zyrtarëve të nivelit të lartë me lobistët nga viti 2024 e në vazhdim. Përcaktimi i rregullave për kufizimin e punësimit pas largimit nga detyra, nga viti 2024 e në vazhdim.	Shtim i përpjekjeve institucionale për të përmbushur rekomandimet e Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) dhe zbatimi në kohë i planit përkatës të veprimit deri në vitin 2024 nëpërmjet veprimeve të koordinuara nga Ministria e Drejtësisë dhe të gjitha institucioneve përgjegjëse. Veprimtari ndërgjegjësuere të zhvilluara me synimin për të siguruar zbatimin efektiv të rekomandimeve, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë në zbatimin e ligjit për konfliktin e interesit dhe rregullave të reja për angazhimin me palët e treta dhe kufizimet e punësimit pas largimit nga detyra. Bërjen e mundur të funksionimit normal të Komisionit të Etikës përmes rishikimit të	Rekomandimet e GRECO-s për Shqipërinë trajtohen në vijimësi që nga viti 2024 e në vazhdim, duke siguruar koherencë më të madhe të kuadrit ligjor dhe kapacitete institucionale për t'i rezistuar kërcënimeve ndaj integritetit. Rekomandime të zbatuara në praktikë përmes zyrtarëve publikë gjithnjë e më të informuar mbi legjislacionin e rishikuar dhe legjislacionin nënligjor nga viti 2024 e në vazhdim.

		përbërjes së tij brenda vitit 2024 e në vazhdim.	
3. Zbatimi i ligjit	Sanksione parandaluese efikase dhe proporcionale ndaj korrupsionit dhe nivel i qëndrueshëm i kapaciteteve për gjykatat e posaçme, BKH, SPAK		
	Sanksione të mjaftueshme parandaluese ndaj korrupsionit në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së dhe Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit të sanksionuara në Kodin Penal deri në vitin 2026. Formalizimi i bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit Shqiptar, SPAK (Prokuroria e Posaçme dhe BKH) për të vendosur modalitetet e bashkëpunimit brenda vitit 2024. Analizë efikasiteti deri në vitin 2024 dhe plani i miratuar nga SPAK-u me synimin për të trajtuar, ndër të tjera, specializimin e brendshëm, dhënien përparësi, kohëzgjatjen e proceseve dhe uljen e çështjeve të mbartura.	Mbajtja e nivelit të duhur të shpërndarjes së burimeve për SPAK-un mbi bazën e rishikimit vjetor për të mbështetur kapacitetet e sektorit të tij për korrupsionin, deri në vitin 2030. Rritja e kapaciteti të BKH-së nëpërmjet rekrutimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, deri në vitin 2025, në përputhje me udhëzimet e Bordit Ndërkombëtar të BKH-së dhe sigurimin e qartësisimit të roleve të tyre funksionale dhe kritereve përzgjedhëse, në përputhje me ligjin për SPAK-un. Ngritjen në BKH-së të një njësie të re përgjimi parandalues, njësie vlerësimi risku dhe njësie bashkëpunimi ndërkombëtar deri në vitin 2025. SPAK-u, gjykata e posaçme me personel të plotë deri në vitin 2024. SPAK-u me sistem të menaxhimit të çështjeve deri në vitin 2027. Rritje e bashkëpunimit ndërmjet prokurorive dhe policisë, përfshirë PP-në, SPAK-un dhe Policinë e Shtetit deri në vitin 2027. Forcimi i kapaciteteve hetimore, duke bërë të mundur aksesin e nevojshëm në bazat e të dhënave shtetërore deri në 2025. SPAK-u zbaton një politikë të qartë komunikimi, duke përfshirë ndërveprimet e tij me shtypin deri në vitin 2025.	Konsolidimi i qëndrueshëm dhe konsistent i agjencive ligjzbatuese të angazhuara në luftën kundër korrupsionit deri në vitin 2027. Kapacitetet e agjencive ligjzbatuese, me fokus të veçantë SPAK për të kryer më mirë hetime proaktive, hetime me elementë ndërkufitarë, hetime rastesh korrupsionit të nivelit të lartë, përfshirë fushat më të prekshme ndaj korrupsionit, rritur deri në vitin 2030. Efikasiteti i bashkëpunimit ndërmjet agjencive përkatëse të zbatimit të ligjit është rritur në praktikë përmes modaliteteve të dakordësuara të bashkëpunimit deri në vitin 2030. Kapacitetet operationale të Prokurorisë së Posaçme dhe BKH-së janë përforcuar në mënyrë të qëndrueshme nga viti 2025 e në vazhdim.
Historiku	Rritje e progresit të mirë fillestar në krijimin e një historiku solid të çështjeve kundër korrupsionit		
Hetimi penal dhe dënimi	Në kuadër të planit të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura nga KLGJ-ja brenda vitit 2024, veprime të veçanta do t'u kushtohen gjykatave të posaçme, me qëllim sigurimin e shpërndarjes së qëndrueshme të burimeve, kapacitete të përshtatshme operationale për reduktimin e kohës së marrjes së vendimit dhe përmirësimin e menaxhimit të gjyqësorëve.	Burimet e përshtatshme të Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit të Ministrisë së Drejtësisë bëjnë të mundur hetimin e shkeljeve të integritetit në administratën publike, duke përfshirë sektorët e prekshëm ndaj korrupsionit, bazuar në parashikimet vjetore të ngritjes së kapaciteteve nga viti 2024 e në vazhdim.	Historik i përmirësuar sistematik të hetimit proaktiv, duke përfshirë fushat më të prirura ndaj korrupsionit, përfshirë dënimet e formës së prerë të nivelit të lartë për korrupsionin, të konsoliduar gjithnjë e më shumë gjatë vitit 2030. Historiku i çështjeve të Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit që ka rezultuar në vazhdimësi me ndjekjen penale nga ana e prokurorive dhe e SPAK-ut, me qëllimin për të synuar sektorët e prekshëm ndaj korrupsionit.

	SPAK-u miraton udhëzime të përgjithshme për hetimin financiar, duke rritur fushëveprimin e hetimit financiar.	Konsolidimi i mëtejshëm i prokurorisë së posaçme në hetimet proaktive (përfshirë hetimin financiar), ndjekjen penale të korrupsionit nëpërmjet burimeve të duhura operationale dhe njerëzore dhe trajnimeve të synuara nga viti 2024 e në vazhdim. Kapacitetet e rritura në mënyrë progresive të SPAK bëjnë të mundur një angazhim të qëndrueshëm në hetime proaktive, duke përfshirë hetimet financiare nga viti 2025 e në vazhdim. Zgjerohet funksionimi operativ dhe specializimi i brendshëm i SPAK-ut për të kryer në mënyrën e duhur hetime proaktive dhe hetimin financiar nëpërmjet rritjes së numrit të prokurorëve dhe hetuesve të trajnuar. Rritje e kapacitetit operacional të gjykatave të posaçme me qëllimin për të zhvilluar procese dhe për të ulur periudhën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve bazuar në parashikimet vjetore në mënyrë sistematike deri në vitin 2030. Standardizimin e programeve të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës të praktikave më të mira në hetimin dhe dënimin kundër korrupsionit, duke përfshirë hetimin financiar për korrupsionin nga viti 2025 e në vazhdim për gjyqtarët dhe prokurorët.	Efikasiteti i gjykatave të posaçme nëpërmjet afateve më të shkurtra në dhënien e vendimeve dhe përmirësimit të menaxhimit të qëndrueshëm të gjyqeve, nga viti 2025 e në vazhdim.
Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë	Legjislacioni i rishikuar dhe udhëzime përkatëse për të siguruar përafrimin me <i>acquis</i> të BE-së për rikuperimin e aseteve deri në vitin 2024. Rritje e bashkëpunimit, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, në çështjet e sekuestrimit dhe konfiskimit përfundimtar të produkteve të veprës penale të korrupsionit nëpërmjet krijimit të Zyrës së Rikuperimit të Pasurive si njësi speciale e Policisë së Shtetit deri në vitin 2024.	Rritje e nivelit të ekspertizës së personelit të Policisë së Shtetit dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin efikas të pasurive në të gjithë policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin deri në vitin 2026 e më tej.	Ndjekje sistematike e konfiskimit të produkteve nga veprat penale të korrupsionit deri në vitin 2030, duke ngushtuar hendekun me pasuritë e sekuestruara. Sigurohet ndjekje sistematike e aseteve të ngrira si rezultat i hetimit financiar deri në vitin 2030. Shqipëria bëhet gjithnjë e më shumë një partner i besueshëm në gjurmimin, ngrirjen, konfiskimin dhe rikuperimin e aseteve kriminale ndërkufitare përmes kapaciteteve operationale të Agjencisë Shqiptare të Rikuperimit të Pasurive deri në vitin 2030. Zyrtarët të aftë dhe të trajnuar të përfshirë në të gjithë ciklin e identifikimit, gjurmimit, ngrirjes, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve bëjnë të mundur procese gjithnjë e më efektive deri në vitin 2030.

III. TË DREJTAT THEMELORE			
III.A. Kuadri i përgjithshëm			
Përafrimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor me <i>acquis</i> të BE-së	Kuvendi miraton ndryshime në Kodin Penal (deri në vitin 2026), Kodin Civil (deri në vitin 2026) ligje të tjera (shih më poshtë) për të siguruar përafrimin me <i>acquis</i> përkatës të BE-së për të drejtat themelore. Shqipëria siguron përafrimin me nenin 3 të Kartës për të Drejtat Themelore, duke ndaluar në mënyrë eksplicite klonimin, përfshirë dispozitat në fushën e mjekësisë dhe biologjisë për të përforcuar garancitë ligjore për integritetin e personave deri në vitin 2030.	Trajnim i palëve të interesuara për çështjet e të drejtave themelore vazhdon të ofrohet nga viti 2024 e në vazhdim bazuar në parashikimet vjetore për agjencitë ligjzbatuese, gjyqtarët dhe prokurorët. Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor, në përputhje me standardet evropiane.	Respektimi, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave themelore sigurohet përmes legjislacionit të përafuar me <i>acquis</i> të BE-së, të drejtat evropiane dhe ndërkombëtare të njeriut deri në vitin 2026 dhe kapacitetit të palëve të interesuara për të vepruar në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut vijon të rritet në mënyrë të qëndrueshme deri në vitin 2030.
Rritja e kapaciteteve të organeve të të drejtave të njeriut dhe bërja e mundur e mbledhjes së të dhënave në fushën e të drejtave themelore	Kuvendi miraton ndryshimin e ligjit për Avokatin e Popullit (neni 28) lidhur me detyrimin e publikimit të raportit vjetor. Qeveria Shqiptare merr masat përkatëse për krijimin e një metodologjie të grumbullimit të të dhënave për një vlerësim të duhur të nivelit të zbatimit të politikave dhe strategjive të legjislacionit për të drejtat e njeriut, si pjesë e pjesëmarrjes së Shqipërisë në FRA deri në vitin 2026, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë. Ngrihet një grup pune ndërinstitutional për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë deri në vitin 2024.	Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisioneri për Mosdiskriminimin kryejnë një analizë për nevojën e forcimit të kapaciteteve brenda vitit 2024 për të siguruar burime të përshtatshme bazuar në parashikimet vjetore nga viti 2026 e në vazhdim. Parlamenti nxit aktivitetet e tij mbikëqyrëse me qëllimin për të siguruar një zbatim më të mirë të rekomandimit të Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave deri në vitin 2026. Mekanizmat janë funksionalë dhe sigurojnë emërimin e anëtarëve të institucioneve të pavarura në kohë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, PP-ja dhe KLGJ-ja sigurojnë mbledhjen dhe raportimin e të dhënave përkatëse për krimin e urrejtjes bazuar në udhëzimet e PP-së të vitit 2019 duke reflektuar rekomandimet e ODHIR-iy, deri në vitin 2026. PP-ja mbledh dhe publikon periodikisht të dhëna për veprat penale të lidhura me gjakmarrjen nga viti 2024 e në vazhdim, dhe siguron monitorimin e saj të qëndrueshëm dhe mjetet juridike efektive. Bëhen përpjekje për krijimin dhe publikimin e një baze të dhënash të konsoliduar të personave të zhdukur të kohës së komunizmit, brenda vitit 2027.	Sigurohen në mënyrë progresive burime të qëndrueshme të duhura të organeve kryesore të të drejtave themelore deri në vitin 2030. Sigurohet mbikëqyrje e qëndrueshme e Kuvendit për zbatimin e vendimeve të Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, nga viti 2025 e në vazhdim. Ndjekja gjyqësore e vendimeve të të dy komisionerëve kryhet në kohën e duhur. Sigurohet në mënyrë progresive përmirësimi i historikut dhe zbatimi sistematik i rekomandimeve të Avokatit të Popullit deri në vitin 2030. Politikëbërja për çështje që lidhen me të drejtat themelore përmirësohet vazhdimisht, bazuar në metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe analizën e të dhënave nga viti 2026 e në vazhdim, duke përfshirë të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë (Census). Veprat penale të lidhura me gjakmarrjen ndiqen bazuar në të dhëna të qarta në dispozicion nga viti 2024 e në vazhdim. Përmirësohet vazhdimisht përpunimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë, të mbledhura dhe të publikuara deri në vitin 2030
Rritje e mëtejshme e të drejtave të	Në vitin 2024 miratohet Masterplani i Burgjeve,	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe	Raportet e CPT-së tregojnë progres të qëndrueshëm në trajtimin e të

personave të dënuar apo të paraburgosur	duke përfshirë ndër të tjera masa për rinovimin e infrastrukturës së burgjeve dhe rritjen e kapaciteteve akomoduese për të burgosurit. Plani i Integritetit që trajton rreziqet ndaj integritetit në funksionimin e sistemit të burgjeve, brenda vitit 2024. Drejtori i përgjithshëm i Burgjeve miraton rregulla të brendshme për çdo institucion të ekzekutimit të vendimeve penale deri në vitin 2024, duke synuar trajtimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT) Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miraton një paketë procedurash standarde funksionimi dhe udhëzime për garantimin e cilësisë së kujdesit mjekoligjor deri në vitin 2027.	Ministria e Drejtësisë vijojnë të ndërmarrin masa për ngritjen e kapaciteteve për të rritur aftësinë raportuese dhe zbatuese të rekomandimeve të CPT-së. Rikategorizim progresiv i të burgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, bazuar në nivelin e rrezikshmërisë së tyre, me qëllim stabilizimin gradual të procesit të lirim të progresiv të të burgosurve deri në vitin 2027. Përmirësimi i ndërhyrjes dhe pasurimi i portofolit të stafit me instrumente psikoedukative dhe terapeutike, këshillim klinik, qasje terapeutike, maksimizimi i mbështetjes psikosociale deri në vitin 2027. Forcimi i ndërveprimit ndërinstitucional në lidhje me ndihmën pas dhënies së vendimit penal deri në vitin 2027. Qeveria siguron burime të përshtatshme dhe siguron ndërtimin ose rinovimin e burgjeve deri në vitin 2030, ku 1 burg do të përfundojë deri në vitin 2024 dhe 3 të tjerë deri në vitin 2026. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve zbaton Planin e Integritetit dhe vazhdon të trajtojë rreziqet e korrupsionit. Sigurimi i burimeve të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e Institucionit të Posaçëm Mjekësor për trajtimin e pacientëve mjekoligjor, brenda vitit 2028. Bashkëpunim efikas mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë, duke u përqendruar te pacientët mjekoligjorë. Veprimtaritë lidhur me drejtësinë për të miturit trajtohen në seksionin e të Drejtave të Fëmijëve.	paraburgosurve dhe të burgosurve. Monitorohen vazhdimisht rreziqet e integritetit në sistemin e burgjeve nga viti 2025 e në vazhdim. Trajtimi i përshtatshëm i infrastrukturës, i burgjeve i përmirësuar vazhdimisht nga viti 2024 e në vazhdim. Sigurohet kujdesi i duhur psikiatrik mjekoligjor, nëpërmjet ofrimit të shërbimit terapeutik, njerëzor dhe të sigurt për pacientët mjekoligjorë, nga viti 2028 e në vazhdim.
III.E Mbrojtja e të dhënave personale			
	Përafrimi ligjor dhe përputhshmëria me GDPR-në dhe direktivën e zbatimit të ligjit sigurohet me miratimin e ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda vitit 2024. Akte nënligjore përkatëse për zbatimin efikas të legjislacionit të përafuar të miratuar 6 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri.	Ofrohet vazhdimisht ngritja e kapaciteteve të përshtatshme për të gjitha palët e interesuara, përfshirë kontrolluesit dhe përpunuesit publikë dhe privatë, në kuadër të programeve vjetore, nga Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave, për të siguruar zbatimin efikas të legjislacionit të miratuar, nga viti 2024 e në vazhdim.	Kuadri ligjor i harmonizuar për mbrojtjen e të dhënave zbatohet në mënyrë të vazhdueshme dhe korrekte nga palët e interesuara të informuara, nga viti 2024 e tutje në përputhje me <i>acquis</i> dhe standardet e BE-së. Kapaciteti i stafit të Komisionerit për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe i stafit të kontrollorëve publikë privatë në të gjithë sektorët e ngarkuar për të garantuar rritjen e mbrojtjes së të dhënave në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së nga viti 2024 e në vazhdim.

		Pavarësia e Komisionerit për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave është rritur në praktikë. Forcimi i kapaciteteve të Komisionerit për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave në përputhje me kompetencat e reja që dalin nga legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale nga viti 2024 e në vazhdim. Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave krijon një rrjet dhe nxit dialogun me Zyrtarët e Mbrojtjes së të Dhënave (DPO), në sektorin publik dhe privat, deri në fund të vitit 2024. Bashkëpunim efektiv ndërmjet AKEP-it, Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave, AKCESK-ut, në zbatimin e rregullave për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave dhe qeveria organizojnë fushata ndërgjegjësuere për kontrollorët publikë dhe privatë, si dhe përmes programeve edukative kushtuar të gjitha grup-moshave (veçanërisht grupeve të prekshme më të ekspozuara) nga viti 2024 e në vazhdim. Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave kryen vazhdimisht hetime efektive për shkeljen e të drejtave të mbrojtjes së të dhënave, përfshirë shkeljet në shkallë të gjerë, bazuar në objektivat dhe afatet e përcaktuara në Strategjinë Institucionale dhe programin vjetor të punës së Komisionerit për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave. Kontrollorët publikë dhe privatë (veçanërisht administratorët e bazave të të dhënave shtetërore dhe më gjerë) marrin masat e nevojshme për të zbatuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe rekomandimet e Komisionerit, për të garantuar sigurinë e të dhënave. Progres i qëndrueshëm drejt garantimit të sigurisë së të dhënave pas hetimeve të qëndrueshme dhe debateve të për shkeljet e të dhënave në shkallë të gjerë, deri në 2030 dhe përtej.	Kontrollorët publikë dhe privatë janë gjithnjë e më të vetëdijshëm për detyrimet që rrjedhin nga ndërgjegjësimi për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale nga viti 2024 e në vazhdim. Publiku është më i informuar për të drejtat e parashikuara në legjislacionin e përafëruar pas fushatave ndërgjegjësuere të zhvilluara nga Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave, nga viti 2024 e në vazhdim. Standardet e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave janë rritur në mënyrë progresive në kontrollorët publikë dhe është përmirësuar infrastruktura e institucioneve përgjegjëse.
III.G Liria e shprehjes përfshirë lirinë dhe pluralizmin e medias			
	Kuadri për t'u miratuar në mënyrë që të:	Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Bizneseve	Pluralizmi i lirisë së medias dhe medias rritet më tej në praktikë në baza

	- Të forcojë efikasitetin e tij dhe autonominë e rregullatorit, për të trajtuar; - Përqendrimin e tregut mediatik, duke forcuar transparencën dhe duke vendosur kufizime për pronësinë e medias dhe shtrirjen e audiencës; - Forcimin e transparencës së financimit dhe pronësisë së medias, duke përfshirë interesat e pronarëve në sektorin mediatik dhe jo mediatik; - Rregullat për ndarjen e reklamave shtetërore dhe burimeve të tjera shtetërore, me qëllim blerjen e mallrave dhe shërbimeve; - Institucione të pavarura që iniciojnë hetime për shkelje të mundshme të rregullave të pronësisë, si dhe për interesa të fshehura të pronarëve, përqendrim të mundshëm, sjellje të koordinuar, konkurrencë të pandershme dhe favore të mundshme që lidhen me shmangien e të drejtave të autorit dhe përfitimin nga reklamat shtetërore dhe fondet shtetërore; - Përforcimin e pavarësisë së transmetuesit publik, veçanërisht për të siguruar që rregullatori të ketë një përbërje pluraliste, të përbëhet nga individë të kualifikuar, të përfaqësojë komunitetin e medias dhe të gëzojë autonomi nga qeveria. Ndryshimet ligjore do të kryhen në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe me objektivin për të arritur harmonizimin e plotë me <i>acquis</i> të BE-së brenda vitit 2026. Ndryshimet ligjore do të pasqyrojnë rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe do t'u nënshtrohen konsultimeve të duhura me organizatat mediatike. AMA miraton rregulloren për transparencën e pronësisë së medias, në përputhje me legjislacionin aktual deri në vitin 2024. Aspektet penale dhe civile të dispozitave në lidhje me shpifjen harmonizohen plotësisht me standardet e BE-së. Dispozitat e ligjit civil për publikimet mashtruese ose të pasakta të përafëruara me standardet dhe rekomandimet evropiane. Afatet e informacionit për aksesin në informacionin me interes publik për gazetarët rishikuar bazuar në standardet dhe praktikën më të mira të BE-së.	rrit monitorimin e zbatimit të ligjit për pronarët përfitues të miratuar në vitin 2020, me synimin për të garantuar transparencë të plotë të pronarëve fundorë të sipërmarrjeve mediatike deri në vitin 2025, me fokus sipërmarrjet mediatike në shkelje të kërkesave të ligjit. AMA ndihmon transmetuesit në sigurimin e një procesi transparent të matjes së audiencës deri në vitin 2028 dhe vazhdon të publikojë Buletinin, në lidhje me dinamikën e tregut mediatik në baza vjetore brenda 6 muajve të çdo viti. Bërja e mundur në praktikë e mbështetjes së transmetuesit publik përmes burimeve të duhura. Krijohet një dialog i strukturuar me median në një mënyrë gjithëpërfshirëse, për të bërë të mundur diskutimin mbi reformën kyçe në sektor dhe inkurajimin, ndër të tjera, për vetërregullim, si dhe arsimimin dhe trajnimin cilësor. Një Agjenci Informative për Media dhe Informim: ndjekja e vlerësimit të pavarur të MIA-së, veçanërisht për informimin e drejtpërdrejtë dhe transparent nga institucionet qeveritare. AMA miraton metodologjinë dhe planin për të ngritur dhe zbatuar një sistem transparent të matjes së audiencës mediatike brenda vitit 2025. Siguria e gazetarëve e garantuar nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të agjencive përkatëse ligjzbatuese. AMA miraton një plan veprimi për sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve deri në vitin 2024.	progresive, pas ndryshimeve legjislative dhe veprimeve të ndërmarra nga autoritetet përkatëse shtetërore në përputhje me <i>acquis</i> përkatës të BE-së dhe standardet ndërkombëtare nga viti 2026 e në vazhdim. Rritje graduale e kapacitetit të përgjithshëm institucional të rregullatorit për të zbatuar kuadrin rregullator në mënyrë sistematike dhe në kohë nga viti 2025 e në vazhdim. Efikasiteti i transmetuesit publik rritet gjithnjë e më shumë për shkak të rishikimit të burimeve të akorduara. Përmirësohet aksesin në informacionin me interes publik në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë transparente.
Siguria e gazetarëve duke përfshirë	Analizë e plotë të padive strategjike kundër	Akademia e Policisë vijon të ofrojë trajnime,	SLAPP-i trajtohet në rastet kur ndodh përmes masave të veçanta

SLAPP-in	pjesëmarrjes publike (SLAPP) përfshirë masa korigjuese, nëse është e nevojshme, qoftë në ligj apo praktikë institucionale, në përputhje me standardet evropiane dhe <i>acquis</i> .	duke përfshirë edhe ndjekjen e rasteve të dhunës ndaj gazetarëve që nga viti 2024, bazuar në planifikimin vjetor. Policia e Shtetit dhe shërbimet e prokurorisë përcaktojnë një pikë kontakti brenda strukturave të tyre, përgjegjëse për trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve, deri në vitin 2024 dhe sigurojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për raste të tilla, nga viti 2024 e në vazhdim. Prokuroria e Përgjithshme publikon rast pas rasti rezultatet e hetimeve për çështjet me gazetarë, nga viti 2024 e në vazhdim. KLGJ-ja mbledh dhe nxjerr të dhëna për rastet e përfshirjes së gazetarëve, nga viti 2023 e në vazhdim. Shkolla e Magjistraturës bën të mundur trajnimin e gjyqtarëve me trajtimin adekuat të SLAPP-in.	përmirësuese nga viti 2025 e në vazhdim. Siguria e çështjeve të lidhura me gazetarët trajtohen vazhdimisht nga të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit, dhe komunikimi për ndjekjen e rasteve që përfshijnë gazetarë rritet më tej deri në vitin 2024 e në vazhdim. Të dhënat historike të hetimit dhe dënimit të rasteve të dhunës ndaj gazetarëve konsolidohen në mënyrë progresive.
Të drejtat në punë së gazetarëve	Inspektorati Shtetëror i Punës miraton një metodologji inspektimi bazuar në rrezik për zbatimin e të drejtave në punë të gazetarëve deri në vitin 2025.	ASPA vijon të ofrojë trajnime për stafin e Inspektoratit Shtetëror të Punës për kryerjen e inspektimeve të bazuara në rrezik për të drejtat në punë të gazetarëve.	Zbatimi i të drejtave në punë në praktikë i nënshtrohet përmirësimit për të siguruar ushtrimin e lirë të profesionit të gazetarëve deri në vitin 2025 e në vazhdim, duke i bërë ata më të qëndrueshëm ndaj kërcënimeve dhe dezinformimit.
III.I Mosdiskriminimi			
	Kuvendi miraton ndryshime në ligjet përkatëse (shih më poshtë për detaje) në mënyrë që të sigurojë harmonizim të plotë me <i>acquis</i> të BE-së deri në vitin 2027, duke përfshirë ndryshimet përkatëse në Kodin Penal (2026).	Burimet e duhura të akorduara Komisionerit për Mosdiskriminimin për të siguruar zbatimin e kuadrit ligjor kundër diskriminimit për çdo rast diskriminimi bazuar në të gjitha bazat e diskriminimit, objekt përmirësimi që nga viti 2024 e në vazhdim. Trajnimi i palëve të interesuara për çështjet e mosdiskriminimit, duke përfshirë stafin arsimor dhe shëndetësor, prokurorët, gjyqtarët, punonjësit socialë, psikologët, policinë, kryhet vazhdimisht bazuar në parashikimet vjetore nga viti 2024 e në vazhdim. Fushatat promovuese për antidiskriminimin zhvillohen në bazë të planeve vjetore nga Komisioneri për Mosdiskriminimin në bashkëpunim me ministrinë e linjës, shoqërinë civile, si dhe medien publike dhe universitetet, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta, në baza vjetore nga viti 2024 e në vazhdim.	Promovimi i mosdiskriminimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi në përputhje të plotë me legjislacionin dhe standardet e BE-së, i bërë të mundur nëpërmjet strukturave ligjore dhe institucionale, me kapacitete gjithnjë e më të mira, deri në vitin 2030. Shkeljet e dispozitave për diskriminimin trajtohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje të plotë me <i>acquis</i> përkatëse të BE-së, deri në vitin 2030.
Krimi i urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes	Rishikimi i Kodit Penal përafruar plotësisht me <i>acquis</i> të BE-së për gjuhën e urrejtjes dhe krimin e urrejtjes, të miratuar nga Parlamenti deri në vitin 2026. Komisioneri për Mosdiskriminimin (si drejtues) bashkë me shoqërinë civile harton udhëzime dhe	Kapacitetet e duhura të agjencive të zbatimit të ligjit dhe zyrtarëve të drejtësisë penale për t'iu përgjigjur rasteve të krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes do të rriten më tej bazuar në parashikimet vjetore. Komisioneri për Mosdiskriminimin, agjencitë e	Rastet e reduktuara të krimit të urrejtjes të bëra të mundur ndër të tjera, nga palë të afta të sigurojnë dhe përgjigjen në mënyrën e duhur, deri në vitin 2030. Është përmirësuar kapaciteti zbatues për zbatimin e standardeve për gjuhën e urrejtjes, përfshirë krimin në internet dhe krimin e urrejtjes nga të gjitha palët e përfshira, nga viti 2030.

	identifikon krimin dhe gjuhën e urrejtjes, deri në vitin 2024.	zbatimit të ligjit dhe gjykatat ndërmarrin hapa të qëndrueshëm për mbledhjen e të dhënave të veçanta dhe statistikave mbi krimin e urrejtjes nga viti 2025 e në vazhdim. Komisioneri për Mosdiskriminimin në bashkëpunim me partnerë të tjerë shtetërorë dhe joshitetërorë ndërmarrin fushata ndërgjegjëse, duke përfshirë zonat rurale bazuar në parashikimet vjetore. AMA nxjerr një plan veprimi për të trajtuar gjuhën e urrejtjes në mediat audiovizuale deri në vitin 2026	Sigurohen në mënyrë progresive mbledhje sistematike të të dhënave dhe statistikave të zbërthyer për krimin e urrejtjes, deri në vitin 2030. Qytetarët janë gjithnjë e më shumë të informuar mbi legjislacionin dhe standardet e lidhura me krimin e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes, deri në vitin 2030. AMA forcon kapacitetin e saj për të trajtuar dhe monitoruar gjuhën e urrejtjes përmes trajnimeve, diskutimeve me grupet e interesit dhe punës për një plan veprimi, deri në vitin 2026
Personat me aftësi të kufizuara	Përafrimi i legjislacionit shqiptar është siguruar me Direktivën (BE) 2016/2102 për aksesin në internet dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik deri në vitin 2024. Shqipëria ratifikon Protokollin Fakultativ të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, deri në vitin 2027.	Financimi i përshtatshëm për ngritjen e shërbimeve me bazë komunitare, veçanërisht për fëmijët, bëhet e mundur në bazë të vlerësimit vjetor të nevojave të personave me aftësi të kufizuara, duke filluar nga viti 2025. Fushata ndërgjegjëse publike për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë fushata ndërgjegjëse për prindërit dhe kujdestarët për rëndësinë e vlerësimit dhe ndërhyrjes së hershme për fëmijët me aftësi të kufizuara, të zhvilluara në bashkëpunim me partnerët bazuar në planifikime vjetore. Zhvillimi i planeve të individualizuara të tranzicionit për qendrat e zhvillimit, duke marrë parasysh nevojat dhe preferencat e tyre të veçanta nga viti 2025 e në vazhdim. Shndërrimi i shkollave të veçanta në qendra burimore me qëllim rritjen e mëtejshme të numrit të klasave zhvillimore për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme deri në vitin 2026. Pajisja e vazhdueshme e shkollave me kabinete shërbimi psiko-social deri në vitin 2026.	Rritje e aksesit për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet me bazë komunitare, duke filluar nga viti 2025. Standardet për shërbimet e bazuara në komunitet përmirësohen gradualisht dhe përafrohen me Standardet Kuadër të BE-së, duke filluar nga viti 2025. Deinstitutionalizimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, i zbatuar në mënyrë progresive dhe i finalizuar deri në vitin 2026. Fëmijët me aftësi të kufizuara përfitojnë nga sistemi i shkollimit i përshtatur me nevojat e tyre bazuar në kapacitete të përmirësuara deri në vitin 2030. Qytetarët në përgjithësi, bizneset dhe institucionet publike janë gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për zbatimin në praktikë të të drejtave ligjore të personave me aftësi të kufizuara deri në vitin 2030.
LGBTIQ+	Ndërmarrja e ndryshimeve përkatëse në Kodin e Familjes për njohjen e bashkëjetesës/martesës civile dhe ndryshimet në ligjin për të drejtën ndërkombëtare private për njohjen ndërkufitare të lidhjeve familjare brenda vitit 2028.	Burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e planit kombëtar për personat LGBTIQ+ 2021–2027 dhe për funksionimin e Drejtorisë së Përfshirjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë nga 2024 e në vazhdim.	Të drejtat e LGBTIQ+ promovohen në praktikë përmes stafit të trajnuar në mënyrën e duhur nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe palëve të tjera përkatëse deri në vitin 2030. Uljë e rasteve të dhunës ndaj LGBTIQ+, për shkak të përmirësimit të sistemit të raportimit dhe dëmshpërblimit.

		Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTIQ+ nëpërmjet hartimit të raporteve periodike, në koordinim me institucionet e linjës dhe të pavarura, lidhur me zbatimin e objektivave të përcaktuar në planin e veprimit.	Për zbatimin e këtij plani hartohen dhe publikohen çdo vit raporte periodike.
III.K. Barazia gjinore dhe të drejtat e grave			
Përafrim i kuadrit ligjor për barazinë gjinore në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së dhe rritja e kapaciteteve institucionale	Kuvendi miraton ndryshime në: - Ligjin për Barazinë Gjinore brenda vitit 2025, për të siguruar përditësimin me standardet më të fundit; - Ligjin për Dhunën në Familje për të siguruar harmonizim të plotë me Konventën e Stambollit, deri në vitin 2030; - Një përkufizim i ri i përdhunimit në Kodin Penal që përfshin mungesën e pëlqimit si element përbërës, deri në vitin 2026; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miraton Planin e Punës për ndjekjen e rekomandimeve të organeve të Konventës CEDAW brenda vitit 2024.	Trajnimi i duhur i pikave të kontaktit me bazë gjinore, stafit të përfshirë në barazinë gjinore dhe dhunën në familje, përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët, agjencitë e zbatimit të ligjit, punonjësit socialë, psikologët, ofrohet nga viti 2024 e në vazhdim bazuar në parashikimet vjetore. Sigurohen burime të përshtatshme financiare dhe njerëzore që Mekanizmi i Barazisë Gjinore të vihet në funksionim nga viti 2025 e tutje dhe të sigurojë zbatimin e duhur të objektivave të Strategjisë dhe Ligjit për Barazinë Gjinore. Organet përkatëse kompetente vazhdojnë të trajtojnë rekomandimet e CEDAW-s, sipas planifikimit dhe monitorohen për progresin e tyre në baza vjetore.	Barazia gjinore promovohet në ligj përmes kuadrit ligjor të harmonizuar me <i>acquis</i> të BE-së dhe Konventa e Stambollit zbatohet vazhdimisht nga viti 2025 e në vijim. Vëzhgimi në praktikë i zbatimit të rregullave të barazisë gjinore sigurohet nga kapacitetet e zgjeruara, përfshirë funksionimin e qëndrueshëm të pikave të kontaktit. Rekomandimet e CEDAW-s trajtohen në vijimësi nga institucionet me kapacitetin e nevojshëm, deri në vitin 2030. Nxjitje e praktikave të barazisë gjinore përmes stafit të trajnuar Staf me kapacitet të përshtatshëm i agjencive të zbatimit të ligjit, prokurorive dhe gjykatave për të trajtuar në mënyrë sistematike dhe në kohë shkeljet ligjore dhe veprat lidhur me gjininë deri në vitin 2030.
Mbrojtja e duhur e viktimave të dhunës me bazë gjinore	Miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për viktimat e krimeve 2024–2030 brenda vitit 2024 për të garantuar harmonizimin me <i>acquis</i> të BE-së, duke përfshirë direktivën për të drejtat e viktimave, si dhe dispozitat për mbrojtjen e viktimave në disa akte ligjore të BE-së dhe dispozitat për kompensimin e viktimave.	Trajnimi i përshtatshëm i stafit të përfshirë ofrohet bazuar në parashikimet vjetore për çështjet e mbrojtjes së viktimave nga viti 2024 e në vazhdim, duke përfshirë gjyqtarët, prokurorët, personelin e burgjeve, personelin e kujdesit shëndetësor dhe arsimor dhe punonjësit socialë. Sigurimi i qëndrueshmërisë së qendrave strehuese nga viti 2026 e në vazhdim, duke siguruar burime të mjaftueshme nga fondet shtetërore, me ndihmën plotësuese të donatorëve.	Dhuna me bazë gjinore është ulur, ndërgjegjësimi është rritur dhe kapaciteti institucional është i përshtatshëm, në lidhje me zbatimin në praktikë të të drejtave të viktimave deri në vitin 2030.
Nxjitje e të drejtave sociale të grave	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave analizojnë hende kun gjinor në paga dhe arsyet e përfaqësimit më të ulët të grave në tregun e punës dhe paraqesin rekomandimet përkatëse për trajtimin e çështjeve deri në vitin 2025.	Sigurohet një mekanizëm për ndjekjen e rekomandimeve të analizës nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga viti 2025 e në vazhdim.	Gratë përfaqësohen gjithnjë e më shumë në mënyrë të barabartë në tregun e punës dhe hende kun gjinor i pagave reduktohet deri në vitin 2030.
III.L Të drejtat e fëmijëve			
Përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kuadrit të mbrojtjes së fëmijëve dhe deinstitutionalizimit			
Përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kuadrit të mbrojtjes së fëmijëve dhe deinstitutionalizimit	Ligji për kujdesin alternativ në përputhje me udhëzimet e OKB-së për kujdesin alternativ deri në vitin 2026 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Mbështetje dhe burime të qëndrueshme të akorduara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në lidhje me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës	Sigurohet në vazhdimësi mirëqenia dhe kalimi i suksesshëm i fëmijëve nga institucionet në mjediset familjare dhe komunitare, duke filluar nga viti 2025 deri në 2027. Fëmijët i nënshtrohen vazhdimisht shërbimit të përmirësuar të kujdesit

	integron Planin e Deinstitutionalizimit në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale 2024–2030, deri në vitin 2024. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: - Kryen një vlerësim të nevojave të komuniteteve lokale, në lidhje me shërbimet e kujdesit për fëmijët, duke përfshirë faktorët e mundshëm të rrezikut për ndarjen e familjes, duke filluar nga viti 2025; - Harton standarde për shërbimin e jetesës së pavarur/gjysmë të pavarur (modeli i shërbimit të komunitetit të të rinjve) për fëmijët dhe të rinjtë nga 14–21 vjeç, deri në vitin 2024; - Nxist formalizimin e bashkëpunimit midis 61 autoriteteve vendore, njërive të mbrojtjes së fëmijëve, ofruesve të kujdesit shëndetësor, institucioneve arsimore dhe OJQ-ve për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj mbështetjes së fëmijëve dhe familjes, duke filluar nga viti 2025.	nga viti 2024 bazuar në parashikimet vjetore. Përparimi në punën e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve matet çdo vit nëpërmjet metodologjisë së hartuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deri në vitin 2024. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të rasteve të fëmijëve (NARU dhe CPU) në nivel lokal, me qëllim përqendrimin e planifikimit të trajtimit në mbështetjen e familjeve në rrezik ndarjeje, në vend të një qasjeje të orientuar drejt institucionalizimit, duke filluar nga viti 2025. Synohet në mënyrë progresive tranzicioni i fëmijëve nga institucionet në mjediset familjare dhe komunitare, nga viti 2025 e në vazhdim.	social, përfshirë zgjerimin e shërbimeve alternative të bazuara në komunitet, duke filluar nga viti 2025. Ulje e rasteve të fëmijëve të institucionalizuar dhe progres drejt kalimit drejt deinstitutionalizimit, finalizuar deri në 2027.
Parandalimi i dhunës së fëmijëve	Policia e Shtetit zbaton dhe ndjek Kodin Penal, Seancën për Mbrojtjen e të Miturve për trajtimin e rasteve të të miturve, duke u ofruar atyre ambiente në dispozicion për kryerjen e intervistave të të miturve në secilën Polici Rrethi: - Bashkëpunon me institucionet përkatëse për të ofruar shërbime psikologjike, asistencë ligjore dhe shërbime sociale për secilin rast; - Zhvillon seanca trajnimi të vazhdueshëm për oficerët e policisë gjyqësore që përfshihen në trajtim gjatë vitit 2024; - Sipas marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit, sipas nevojave, zhvillon seanca të nevojshme trajnuese me oficerët e caktuar të punonjësve të sigurisë, me qëllim sigurimin e ambienteve të sigurta të shkollave për periudhën akademike 2023–2024; - Të gjitha strukturat brenda policisë së qarkut zhvillojnë tema mësimore arsimore për të dhënë informacion mbi kapacitetet e sigurisë për periudhat akademike 2023–2024.	Agjencitë ligjzbatuese të afta për t’u përgjigjur në kohë dhe me efikasitet dhunës dhe kërcënimeve për dhunë ndaj fëmijëve. Ndihma socio-juridike e ofruar rast pas rasti nëpërmjet shërbimeve të ndihmës juridike. Përmirësimi i politikave të sigurisë në internet, duke u përqendruar të pajisjet digjitale për sigurinë e përdorimit të internetit, duke filluar nga viti 2025. Parandalimi dhe ulja e dhunës seksuale nëpërmjet trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve (të punonjësve nga sektorë të ndryshëm si shëndetësia, arsimi, qendrat që ofrojnë shërbime, drejtësia etj.), si dhe nëpërmjet zgjerimit të shërbimeve. Përmirësimi i mekanizmit për sigurinë kibernetike të fëmijëve që parandalon abuzimin seksual në internet, përmes ndërgjegjësimit dhe mjedisit të sigurisë në internet deri në vitin 2025.	Përgjigje e duhur për të gjitha rastet që përfshijnë fëmijët si viktime të të gjitha formave të dhunës, duke i trajtuar në mënyrën e duhur dhe duke u dhënë përgjigje specifike kërcënimeve në rrjet dhe jashtë tij, deri në vitin 2030. Punonjësit trajnohen dhe ndërgjegjësohen për trajtimin e dhunës seksuale çdo vit përmes trajnimeve. Shërbimet për trajtimin e dhunës seksuale janë zgjeruar deri në vitin 2030
Zhdukja e martesës nën-moshë		Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me shoqërinë civile zhvillon një fushatë ndërgjegjësuere kundër martesave nën moshë nga viti 2026 e në vazhdim, duke synuar grupet	Ndërgjegjësimi për rrënjët dhe arsyet për të çrrënjësuar martesat nën moshë është rritur, veçanërisht nga punonjësit socialë, zyrtarët e gjendjeve civile të përfshirë në formalizimin e martesave dhe grupet e prekshme, deri në vitin 2026.

		që janë më të ekspozuara ndaj fenomenit.	
Praktikat miqësore me fëmijët e drejtësisë për të miturit	Qendra për Parandalimin e Krimit të të Miturve zbaton vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e Institutit Multidisiplinor për të Miturit që do të garantojë risocializimin dhe riintegrimin e të miturve në konflikt me ligjin deri në vitin 2025.	Kapacitetet e duhura trajnuese për palët e interesuara për aplikimin e alternativave ndaj sanksioneve dhe drejtësisë restauruese për të miturit në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së vazhdojnë të ofrohen nga viti 2024 e në vazhdim bazuar në parashikimet vjetore për gjyqtarët, prokurorët, policinë, punonjësit socialë dhe psikologët. Teknikat miqësore të marrjes në pyetje për fëmijët vazhdojnë të përdoren vazhdimisht në seksionet e reja më miqësore për fëmijët në komisariatet e policisë dhe prokuroritë.	Rritja e numrit të personave, veçanërisht të miturve, që përfitojnë nga programet e posaçme për risocializim dhe dënime alternative aplikohen vazhdimisht nga viti 2024 e në vazhdim.
III.O E drejta e pronës			
Transparencë, shërbime të sigurta dhe të bazuara në integritet, në lidhje me të drejtat e pronës	Agjencia Shtetërore e Kadastrës kryen një vlerësim rreth rrishtjes së miratimit të planit të integritetit antikorrupsion për Agjencinë, duke përfshirë masat për transparencë dhe efikasitet deri në vitin 2024. Forcimi i sigurisë juridike dhe pritshmërive legjitime për qytetarët dhe biznesin, gjithashtu, gëzimi efektiv i së drejtës themelore të pronës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës siguron: - Përfundimin e digjitalizimit të të dhënave ligjore deri në vitin 2026; - Përfundimin e digjitalizimit të hartës deri në vitin 2026; - Përfundimin e regjistrimit të parë të pronës së paregjistruar deri në vitin 2028; - Digjitalizimin e plotë të procesit të regjistrimit të pronave deri në vitin 2030 bazuar në proceset e brendshme efikase dhe të digjitalizuara të biznesit; - Kontrollin e saktësisë së të dhënave dhe korrigjimi i të dhënave të kryer në mënyrë periodike.	Qëndrueshmëria dhe ruajtja e burimeve njerëzore dhe financiare për funksionimin e duhur të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës rishikohet vazhdimisht nga viti 2025 e në vazhdim për të përmbushur kërkesat e planit të menaxhimit të integruar të tokës. Agjencia Shtetërore e Kadastrës zbaton Planin e Veprimit kundër Korrupsionit për Agjencinë duke përfshirë masa për transparencë dhe efikasitet dhe monitoron dhe vlerëson zbatimin e tij rregullisht nga viti 2025 e në vazhdim.	Titujt e pronësisë të sigurta dhe transparente të arritura në mënyrë progresive deri në vitin 2030 bazuar në parashikimet vjetore. Është ngritur një sistem efikas dhe transparent i regjistrimit dhe i menaxhimit të integruar të pronës, i cili ofron titujt e qartë dhe të sigurt të pronësisë, për të siguruar të drejtën e pronës në praktikë deri në vitin 2030. Të gjitha të dhënat kadastrale, duke përfshirë titujt e pronësisë dhe hartat kadastrale, duhet të digjitalizohen dhe përditësohen me kujdes për të hequr sistematikisht të dhënat e mbivendosura ose të pasakta deri në vitin 2030. Rreziku i shfaqjes së korrupsionit në Agjencinë e Kadastrës është ulur ndjeshëm deri në vitin 2030, duke siguruar zbatimin dhe monitorimin e duhur të Planit të Veprimit të Integritetit për Antikorrupsionin.
Zbatimi i qëndrueshëm i vendimeve të gjykatave në fushën e pronës, përfshirë GJEDNJ-në		Trajnim konsistent dhe i duhur i gjyqtarëve, prokurorëve, policisë, stafit të Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit për zbatimin e plotë dhe standardet e parashikuara në praktikën gjyqësore përkatëse të GJEDNJ-së për çështje të lidhura me pronat, përfshirë shpronësimet e gabuara, nga viti 2024, bazuar në parashikime vjetore. Burime njerëzore dhe financiare të përshtatshme për funksionimin e duhur të Agjencisë për Trajtimin e Pronave, me qëllim përfundimin e procesit kalimtar të kompensimit të akorduar në mënyrë të qëndrueshme, që nga viti 2024 e në vazhdim. Agjencia e Trajtit të Pronave shton përpjekjet	Shqipëria vijon përpjekjet e saj për zbatimin e duhur të vendimeve të GJEDNJ-së në fushën e të drejtave të pronës. Progresi i qëndrueshëm drejt zbatimit të të drejtave të palëve të prekura nga shpronësimet e gabuara gjatë regjimit komunist, të jetë në mënyrë të drejtë dhe në kohë deri në vitin 2030.

		për të vijuar me kompensimin e pronave të shpronësuara në mënyrë të paligjshme të të gjitha palëve të prekura që të përfundojë deri në vitin 2026, duke garantuar transparencë në të gjithë procesin.	
III.R Të drejtat e personave që u përkasin pakicave dhe të drejtat kulturore			
	Miratimin e legjislacionit zbatues lidhur me vetë-identifikimin dhe të drejta të tjera të lidhura me të dhe përdorimin e gjuhës, bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, deri në fund të vitit 2024, duke siguruar zbatimin dhe respektimin e të drejtave të parashikuara në ligj, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e pakicave.	Komiteti Shtetëror të Pakicave Kombëtare i akordohen burime të përshtatshme, plotësisht funksional, bazuar në parashikimet vjetore, që nga viti 2025 e në vazhdim, dhe nxitja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për të kryer aktivitetet për ndërgjegjësimin për të drejtat e njerëzve që u përkasin pakicave kombëtare. Pjesëmarrja në iniciativa që prekin të drejtat e pakicave kryhet në mënyrë progresive. Minoritetet kanë mekanizma për të kanalizuar pakënaqësitë e tyre në nivel kombëtar dhe lokal. Fondi i pakicave kombëtare ka për qëllim sigurimin e promovimit në të madh të identitetit kombëtar, gjuhësor dhe kulturor të pakicave kombëtare bazuar në parashikimet vjetore, që nga viti 2025 e në vazhdim. Sigurimi i zbatimit të kuadrit ligjor, në lidhje me procesin e mbledhjes së të dhënave sipas nenit 7 të ligjit për pakicat kombëtare, është përmirësuar vazhdimisht nga viti 2025 e në vazhdim. Zbatimi i duhur i ligjit për pakicat kombëtare dhe legjislacionit përkatës për përdorimin e gjuhës së personave që u përkasin pakicave kombëtare që tradicionalisht banojnë ose përbëjnë mbi 20 për qind të popullsisë totale të autoriteteve vendore në njësinë e qeverisjes vendore trajtohet në mënyrë progresive nga viti 2025 e në vazhdim. Sigurimi i personelit dhe trajnimit të duhur të autoriteteve vendore për të siguruar zbatimin e ligjit për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe akteve nënligjore përkatëse, në lidhje me zbatimin e të drejtave të pakicave bazuar në parashikimet vjetore nga viti 2025 e në vazhdim, duke përfshirë, ndër të tjera, kapacitetet për mbledhjen e të dhënave.	Respektimi i të drejtave të personave që u përkasin pakicave promovohet vazhdimisht në praktikë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare deri në vitin 2030. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare nga Komiteti Shtetëror i Pakicave Kombëtare, kapacitete të rritura nga viti 2024 e në vazhdim, duke siguruar aplikimin në praktikë dhe zbatimin e legjislacionit. Sigurohet mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, përfshirë ato kulturore, etnike, gjuhësore, tradicionale, fetare, nëpërmjet rritjes së konsiderueshme të kapaciteteve financuese nga viti 2025 e në vazhdim. Mbledhja e të dhënave për pakicat kombëtare është përmirësuar përmes një procesi sistematik të mbledhjes së të dhënave deri në vitin 2030, përmes aplikimit të vijueshëm në praktikë të legjislacionit përkatës.
Forcimi i pjesëmarrjes në politikëbërje dhe konsolidimi e Pikës Kombëtare të Kontaktit të Romëve			
	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ngrë	Shpërndarja e burimeve trajtohet vazhdimisht me	Rritja progresive e pjesëmarrjes së romëve në shoqëri trajtohet gjithnjë e

	një platformë komunikimi për koordinimin e politikave në nivel qendror dhe lokal, duke përfshirë shoqërinë civile deri në vitin 2024, duke siguruar pjesëmarrjen e romëve në politikat përkatëse kombëtare.	qëllim që të sigurohet zbatimi efikas i masave të politikave për rritjen e pjesëmarrjes së romëve në shoqëri, duke përfshirë rritjen e burimeve njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për koordinimin e politikave që lidhen me minoritetet rome dhe rritjen e kapaciteteve administrative për të punuar për përfshirjen e romëve në nivel rajonal. Forcimi i mëtejshëm i rolit koordinues dhe i mandatit të pikës kombëtare të kontaktit të romëve sigurohet nga viti 2024 e në vazhdim, për të përmirësuar koordinimin me ministrinë e linjës, si dhe në nivel lokal dhe rajonal.	më shumë përmes politikave dhe masave të koordinuara, duke siguruar përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile rome në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave përkatëse. Përparim i vazhdueshëm drejt përbushjes së angazhimeve të Poznanit në fushën e strehimit, shëndetësisë, arsimit dhe regjistrimit civil.
Zbatimi i angazhimeve të Poznanit në fushën e arsimit	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vlerëson situatën, në lidhje me aksesin në shërbimet digjitale për romët dhe egjiptianët, harton një plan veprimi deri në vitin 2024. Plan veprimit për veçimin e shkollave i hartuar brenda vitit 2025 duke trajtuar në veçanti: - Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të angazhimeve të Deklaratës së Poznanit; - Zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së; - Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere (fushatë kundër antiegiptianëve dhe diskriminimit, brenda vitit 2024); - trajnim dhe ngritje kapaciteti.	Shpërndarja e burimeve është trajtuar në mënyrë të qëndrueshme për të siguruar zbatimin efektiv të të dyja planeve të veprimit në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 2025 e në vazhdim. Sigurimi i zbatimit të duhur të programit “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë përmes operacionit GovTech”, duke përfshirë aksesin në shërbimet digjitale nga romët dhe egjiptianët deri në vitin 2027.	Ulet gradualisht veçimi i romëve në sistemin arsimor, në përputhje me objektivin kryesor të kuadrit strategjik të romëve të BE-së për të ulur të paktën në gjysmën e përqindjes së fëmijëve romë që ndjekin shkollat fillore të veçuara deri në vitin 2030 dhe rritjen e aftësive digjitale deri në vitin 2027 e tutje.
Zbatimi i angazhimeve të Poznanit në fushën e punës dhe shëndetësisë.	Kuvendi miraton ndryshimet në ligjin për strehimin social për të përmirësuar aksesin në banesa sociale për romët dhe egjiptianët, me synim zbatimin e kuotës ligjore prej 5%, deri në vitin 2027.	Burimet e duhura të akorduara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për rritjen e aksesit në punësim nëpërmjet përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve në programet e nxitjes së punësimit nga viti 2025 e në vazhdim. Rritje e aksesit efektiv të barabartë në shërbimet shëndetësore për romët dhe egjiptianët, duke përfshirë punonjësit psikosocialë në qendrat shëndetësore që nga viti 2025 e në vazhdim dhe duke siguruar që nevojat e grave, fëmijëve dhe grupeve në nevojë të trajtohen vazhdimisht në të gjitha fushat e shërbimeve shëndetësore.	Aksesi i romëve dhe i egjiptianëve në tregun e punës, strehimin dhe kujdesin shëndetësor trajtohet në mënyrë progresive deri në vitin 2030 me synimin për të arritur objektivat kryesorë sasiore për punësimin, strehimin dhe shëndetin të përfshirë në kuadrin strategjik të romëve të BE-së deri në vitin 2030.
IV. Të drejtat e shtetësisë së BE-së			
		Shqipëria do të vijojë të punojë për të qenë në gjendje të zbatojë pjesët përkatëse të <i>acquis</i> të BE-së përpara anëtarësimit. Shqipëria do të sigurojë përputhjen me <i>acquis</i> të BE-së, në lidhje me skemat e shtetësisë së investitorëve.	Sigurohet në praktikë përputhshmëri me <i>acquis</i> të BE-së, në lidhje me skemat e shtetësisë.

FUSHAT DHE NËNFUSHAT	KUADRI STRATEGJIK/LEGJISLATIV/ INSTITUCIONAL	KAPACITETI INSTITUCIONAL DHE ZBATUES	PERFORMANCA
KAPITULLI 24. LIRIA DHE SIGURIA E DREJTËSISË			
LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR			
IV.1. Kuadri i përgjithshëm IV.1.1 Krimi i organizuar dhe pastrimi i parave janë të kriminalizuara me ligj. Sigurohen hetime, ndjekje penale dhe gjykime efektive, me dënime përfundimtare. IV.1.2 Hetimet financiare shoqërojnë sistematikisht procedimin penal. IV.1.3 Ekziston një sistem i fuqishëm i ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të pronës dhe gjobave financiare. IV.1.4 Të gjithë zinxhirët ligjzbatues dhe gjyqësorë kanë qasje strategjike, të integruar, si dhe burime dhe specializim të përshtatshëm. IV.1.5 Ekziston koordinimi ndërmjet aktorëve të përfshirë dhe burimet adekuate të alokuara për institucionet përgjegjëse për luftën kundër krimit të organizuar. IV.1.6 Ekziston një institucion policor profesional, i besueshëm dhe efikas për të garantuar sundimin e ligjit brenda vendit dhe për të qenë një partner i besueshëm [për shtetet e tjera anëtare, agjencitë e BE-së, vendet e treta dhe partnerët ndërkombëtarë] në hetimet përkatëse dhe çështjet penale, si dhe procese të tjera gjyqësore me aspekt ndërkombëtar. IV.1.7 Vendi bashkëpunon në mënyrë efektive me Eurojust, Europol dhe CEPOL, dhe merr pjesë në EMPACT	Zbatimi i qëndrueshëm i Strategjisë për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda dhe Planit të Veprimit 2023–2025, rinovimi dhe ndjekja e tij për periudhën 2026–2030, duke u dhënë përparësi masave që synojnë goditjen e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Miratimi deri në vitin 2025 i një strategjie kombëtare dhe i planit të veprimit për rikuperimin e aseteve, në përputhje me të gjitha <i>acquis</i> përkatëse të BE-së. Rishikimi dhe miratimi i ndryshimeve të mëtejshme ligjore, në lidhje me Policinë e Shtetit (2024) dhe bashkëpunimin në zbatimin e ligjit, luftën kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, krimit kibernetik, trafikimit të qenieve njerëzore dhe armëve të zjarrit deri në vitin 2026, në përputhje me të gjitha <i>acquis</i> përkatëse të BE-së. Krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Pasurive brenda vitit 2024. Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës për të kuptuar nëse afatet kohore të ngrirjes së aseteve kërkojnë më shumë shtrirje. Forcimi i masave mbrojtëse ligjore për përdorimin e mbikëqyrjes. Rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Kolegjit Evropian të Policisë (CEPOL) për të rritur bashkëpunimin (2024). Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës për të kuptuar nëse legjislacioni mbulon ngrirjen e teknologjive të reja dhe përdorimin e masave të veçanta hetimore për teknologjitë e avancuara.	Sigurimi i një institucioni policor më efektiv, profesional dhe më të besueshëm bazuar në ligjin e rishikuar të PSH-së. Strukturat e hetimit policor të jenë të pajisura dhe të trajnuara në mënyrë adekuate, për të nisur dhe drejtuar hetime financiare proaktive, paralelisht me hetimin kriminal të veprimtarive kriminale të organizuara. Sigurimi i një koordinimi më të ngushtë dhe më efektiv ndërinstitucional, veçanërisht ndërmjet agjencive ligjzbatuese (ALZ) dhe ndërmjet ALZ-ve dhe prokurorisë Përcaktimi dhe zbatimi i një politike të integruar penale për të ndihmuar Prokurorinë e Përgjithshme dhe SPAK-un të përcaktojnë rastet prioritare, ku duhet të fokusohen dhe të kryejnë ndjekjen penale. Konsolidimi i mëtejshëm i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Rritja progresive e aksesit në bazat e të dhënave për ALZ, Prokurorinë Speciale dhe Byronë Kombëtare të Hetimit. Krijimi deri në vitin 2024 i një strukture funksionale të Rikuperimit të Aseteve me staf të trajnuar në mënyrë adekuate, logjistikë dhe rritje të aksesit në regjistrat publikë. BKH-ja të marrë pjesë në platformën EMPACT sa më shpejt të jetë e mundur deri në vitin 2025. Ngritja dhe sigurimi i funksionalitetit të plotë të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve të SPAK-ut brenda vitit 2027. Sigurimi i monitorimit të vazhdueshëm dhe sanksioneve administrative, në rastet e shkeljes së kërkesave të transparencës financiare nga subjektet e detyruara të raportojnë për pronësinë përfutuese. Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme dhe aktiviteteve të përbashkëta, që synojnë rritjen e kapaciteteve hetuese të policisë gjyqësore dhe prokurorëve në nivel vendor, SPAK-ut dhe BKH-së, me qëllim luftën efektive ndaj krimit financiar, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar. Shkëmbimi i informacionit dhe pjesëmarrja në operacionet e përbashkëta dhe ditët e veprimit të përbashkët me agjencitë ligjzbatuese të shteteve anëtare të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar dhe për të përmirësuar bashkëpunimin me Europolin dhe EMPACT-in. Fuqizimi i kapaciteteve ligj zbatuese për të zbatuar masa të veçanta hetimore ose teknologji të reja.	Krimi i organizuar të frenohet nëpërmjet përdorimit të hetimeve gjithnjë e më proaktive dhe efektive, veçanërisht të fokusuara në aspektet financiare, duke përfshirë dyshimet e lidhura me korrupsionin dhe pastrimin e parave, duke çuar në mënyrë progresive në një historik të përmirësuar dhe të plotë të ndjekjeve penale, dënimeve, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale. Rritja e përdorimit të teknikave speciale të hetimit. Përdorimi i shtuar dhe sistematik i hetimeve financiare (paralele). Shënjestrimi i flukseve të parave që mbështesin organizatat kriminale më shumë sesa shënjestrimi i individëve të vetëm. Përmirësimi progresiv i historikut të sekuestrimeve dhe konfiskimeve parandaluese të aseteve, duke përfshirë konfiskimin, jo të bazuar në dënim dhe konfiskimin nga palët e treta. Promovimi dhe aplikimi gjithnjë e më shumë i ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara. Përmirësimi i kapaciteteve të ruajtjes dhe i menaxhimit të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht një historik i qëndrueshëm, në lidhje me pjesëmarrjen dhe kontributin proaktiv të ALZ-së dhe prokurorisë në institucionet dhe platformat e lidhura me BE-në, duke përfshirë edhe Shtetet Anëtare.

		Fuqizimi i kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve për përdorimin e provave indirekte për kryerjen e hetimeve financiare.	
2. Krimi kibernetik IV.2.1 Legjislacioni është përafuar dhe zbatuar në mënyrë efektive me kapacitetin e duhur (përfshirë pajisjet dhe personelin e specializuar).	Zbatimi i qëndrueshëm i Strategjisë Kombëtare ekzistuese të Hetimit të Krimit Kibernetik në Shqipëri 2021–2025 dhe Planit të Veprimit Shtesë deri në vitin 2025, duke përfshirë rinovimin dhe ndjekjen e tyre për periudhën 2026–2030. Sigurimi i ndryshimeve të mëtejshme të legjislacionit kombëtar, duke përfshirë përafrimin e tij me Direktivën (BE) 2019/713 dhe Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike (2025)	Sigurimi i hetimit sistematik të krimeve kompjuterike nga dhe nën drejtimin e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike në PSH. Pajisja e PSH-së me kapacitete laboratorike të kriminalistikës së krimit kibernetik, si në nivel qendror ashtu edhe në terren (2024) Ofrimi i trajnimeve dhe aktiviteteve sensibilizuese për prokurorët për të përmirësuar përdorimin e rrjetit të pikave të kontaktit 24/7 të krijuar nga Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik (në vazhdimësi)	Rrezik i reduktuar i krimit kibernetik përmes zbatimit të Konventës së Budapestit për krimin kibernetik, Protokolli i Dytë Shtesë. Rritja e ndërgjegjësimit të prokurorëve për përdorimin e rrjetit 24/7 të kontaktit të KiE për krimin kibernetik, lidhur me numrin e trajnimeve të ofruara dhe numrin e prokurorëve të trajnuar. Historik i përmirësuar mbi krimin kibernetik.
3. Abuzimi seksual i fëmijëve, përfshirë online IV.3.1 Legjislacioni është përafuar dhe zbatuar në mënyrë efektive me kapacitetin e duhur (përfshirë pajisjet dhe personelin e specializuar). IV.3.2 Ekzistojnë masat për zbulimin, mbrojtjen dhe kujdesin ndaj viktimave dhe ato zbatohen në mënyrë efektive.	Miratimi i ndryshimeve ligjore përkatëse në mënyrë që të kriminalizohen të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet dhe sigurimi i përafrimit të ligjit nr. 10192/2009 me direktivën e BE-së 2011/93.	Rritja e kapaciteteve teknike për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve ndaj fëmijëve të kryera përmes internetit. Rritja e numrit të reaguesve të parë të PSH-së të trajnuar ndaj abuzimit të fëmijëve në nivel qarku.	Mbrojtje dhe parandalim i zgjeruar (përfshirë parandalimin e riviktimizimit) të abuzimit seksual të fëmijëve <i>online</i> dhe <i>off line</i>
4. Trafikimi i armëve të zjarrit IV.4.1 Legjislacioni është përafuar dhe zbatuar në mënyrë efektive me kapacitetin e duhur (përfshirë pajisjet dhe personelin e specializuar). IV.4.2 Kjo përfshin, gjithashtu, kontrollin e armëve të zjarrit, komponentëve thelbësorë dhe municionit dhe kapacitetin e sigurt të ruajtjes dhe shkatërrimit.	Miratimi i ligjit “Për protokollin e armëve të zjarrit” deri në vitin 2025; Rishikimi i neneve të veprave penale të armëve të zjarrit në Kodin Penal për t’i harmonizuar plotësisht me protokollin e OKB-së për armët e zjarrit deri në vitin 2025; Rishikimi i Procedurave Standarde të Punës dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit ekzistues për luftimin e trafikut të paligjshëm të AVL-ve në pakot postare (deri në fund të vitit 2024).	Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024 dhe Planit të Veprimit Plotësues 2022–2024, duke përfshirë rinovimin e tyre deri në fund të 2024 dhe ndjekjen në përputhje me kuadrin strategjik rajonal përkatës për periudhën 2025–2030 *(Udhërrëfyesi 2.0 i BB-së për AVL-të). Komisioni Kombëtar i AVL-ve bazohet në përvojën e tij pozitive dhe vazhdon të sigurojë koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të objektivave strategjikë që lidhen me kontrollin e AVL-ve. Rritja në mënyrë progresive e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të AL-së, duke përfshirë autoritetet doganore dhe postare, prokurorët për parandalimin, gjurmimin, zbulimin, hetimin e aktiviteteve të paligjshme, në lidhje me AVL-të (2024 e në vazhdim). Ngritja e një Njësie Qendrore plotësisht funksionale të armëve të zjarrit pranë PSH-së deri në vitin 2024, e cila merr pjesë aktive në bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e informacionit; Përmirësimi i aksesit dhe përdorimi më efikas dhe efektiv i sistemeve/mjeteve/bazave të të dhënave të lidhura me balistikën, duke përfshirë Qendrën e Inteligjencës së Armëve të zjarrit të BE-së, Sistemin e Informacionit të Europol, Trafikun, EVOFINDER, që çojnë në hetime të drejtuara nga intelijenca përmes identifikimit balistik, referencës dhe ekzaminimeve. Krijimi i infrastrukturës së duhur për çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe forcimin e menaxhimit të inventarit dhe rritja e aftësive të mbikëqyrjes, si dhe të sigurisë fizike dhe mbrojtjes së rezervave deri në vitin 2025. Rritja e kapaciteteve të njësisë qendrore të sapokrijuar të Armëve të	Veprimet kombëtare në përputhje të plotë me Udhërrëfyesin për Kontrollin e AVL-ve të Ballkanit Perëndimor. Reagimi i koordinuar në nivel strategjik dhe operacional për luftimin e trafikimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit; Përmirësimi i historikut të parandalimit të trafikimit të armëve të vogla, municioneve dhe prekursorët shpërthyes nga autoritetet doganore dhe policia kufitare. Zvogëlimi i disponueshmërisë së armëve të paligjshme të zjarrit nëpërmjet legalizimit, dorëzimit vullnetar dhe çaktivizimit të tyre.

		Zjarrit, duke siguruar akses dhe ndërveprim të bazave të të dhënave (2024–mesi i 2025). Forcimi i kapaciteteve dhe i procedurave të kontrollit kufitar kundër trafikimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (FAE) sipas udhërrëfyesit ekzistues dhe të rinovuar rajonal për AVL-të dhe strategjive kombëtare përkatëse (mesi i vitit 2024 deri në 2025). Rritja e përpjekjeve për ndërgjegjësimin, informimin dhe edukimin mbi risqet dhe rreziqet që lidhen me keqpërdorimin, mbajtjen pa leje dhe trafikimin e armëve të zjarrit/AVL, si dhe reduktimin e armëve të zjarrit të paligjshme nëpërmjet legalizimit, dorëzimit vullnetar dhe çaktivizimit (2024 e në vazhdim).	
5. Trafikimi i qenieve njerëzore IV.5.1 Legjislacioni është përafëruar dhe zbatuar në mënyrë efektive me kapacitetin e duhur. IV.5.2 Ekzistojnë masat për zbulimin, mbrojtjen dhe kujdesin ndaj viktimave dhe zbatohen në mënyrë efektive.	Miratimi i Planit të ri të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2024) Përmirësimi deri në vitin 2026 i kuadrit legjislativ në lidhje me kriminalizimin e veprave (Kodi Penal) dhe zbatimin e ndryshimeve të miratuara, në lidhje me viktimat (Kodi i Procedurës Penale).	Plani i Veprimit 2024-2025 parashikon dhe ofron trajnime dhe qasje të vazhdueshme me fokus viktimat për agjencitë ligjzbatuese, autoritetet gjyqësore, shoqërinë civile, punonjësit socialë, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, ofruesit e shërbimit të arsimit dhe të kujdesit shëndetësor. Alokimi i fondeve nga buxheti i shtetit, krahas mbështetjes së dhënë nga donatorë ndërkombëtarë, organizata dhe OJF për zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit 2024-2025. Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave, intervistimit dhe kapaciteteve analitike të policisë kriminale dhe prokurorisë, nëpërmjet mbështetjes teknike dhe teknologjike, duke përfshirë softuerin që çon në hetime cilësore dhe më efektive dhe ndjekje penale të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore (2025). Sigurimi i kapaciteteve të përshtatshme teknike midis oficerëve të policisë, inspektorëve të punës, rojeve kufitare, prokurorëve dhe gjyqtarëve që çojnë në identifikimin dhe referimin efektiv të viktimave në shërbimet mbështetëse, dhe ndërgjegjësimin e rritur për rolin e tyre gjatë procedimit penal (mesi i vitit 2025 deri në vitin 2026). Zbatimi i Marrëveshjes për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të qershorit 2023 për të siguruar identifikimin, referimin, ndihmën dhe riintegrimin e tyre. Forcimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet legjislacionit të përmirësuar, rritjes së numrit të shërbimeve për fëmijët në mbrojtje (duke përfshirë viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit), forcimin e kapaciteteve të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe rritjen e fushatave ndërgjegjësuere për parandalimin e fenomenit të trafikimit. Sigurimi i një linjë telefonike konfidenciale për viktimat, të mbijetuarit dhe dëshmitarët e trafikimit të qenieve njerëzore deri në vitin 2025. Zhvillimi i fushatave të dedikuara për rritjen e ndërgjegjësisimit, në	Identifikimi i hershëm i viktimave të mundshme, veçanërisht në mesin emigrantëve vulnerabel që hyjnë në Shqipëri, të përmirësohet vazhdimisht nëpërmjet rritjes së kapaciteteve adekuate teknike të punonjësve të policisë, punonjësve socialë, punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve etj. Viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të identifikohen në përputhje me Procedurat Standarde Operative të miratuara nga qeveria. Hetimi i shtuar dhe intensifikimi i ndjekjeve penale të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore përmes një programi të dedikuar për ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe logjistike në koordinim me mbështetjen e BE-së për të forcuar Luftën kundër Kontrabandimit të Emigrantëve dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor. Ndihma e përmirësuar dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Kuadër i përmirësuar legjislativ për mbrojtjen e viktimave.

		bashkëpunim me OSHC-të për të synuar komunitetet në rrezik të trafikimit të qenieve njerëzore (2024 e në vazhdim). Vazhdimi i mbështetjes së qendrave joshitetërore, të pritjes dhe integritimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit.	
BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E DROGËS			
V.1.1 Ekzistojnë masat e parandalimit dhe reduktimit të kërkesës dhe zbatohen në mënyrë efektive. V.1.2 Sistemi Kombëtar i Paralajmërimit të Hershëm (NEWS) dhe Observatori Kombëtar i Drogës (NDO) bashkëpunojnë në mënyrë efektive me EMCDDA. V.1.3 Kapacitetet e ruajtjes dhe shkatërrimit të barnave janë të mjaftueshme.	Ndjekja e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Shëndetit 2021–2030, duke përfshirë rishikimin e kuadrit legjislativ dhe strategjik, në lidhje me Parandalimin, Trajtimin dhe Reduktimin e Dëmtimeve të Lidhura me Drogat (2025) Sigurimi i përafrimit të kuadrit legjislativ në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së për kriminalizimin e trafikimit të drogave të paligjshme dhe transmetimin e mostrave të substancave të kontrolluara deri në vitin 2026. Përditësimi i legjislacionit vendës përkatës për substancat psikoaktive dhe prekursorët deri në vitin 2025 dhe përditësimi i rregullit të listës së substancave psikoaktive të ndaluara. Krijimi i bazës ligjore për një proces të përshtatshëm për asgjësimin e prekursorëve (2025). Miratimi i kuadrit ligjor përkatës për krijimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm (2025) dhe Observatori Kombëtar i Informacionit për Drogën deri në vitin 2026. Miratimi i një udhëzimi të përbashkët për procedurën e asgjësimit të narkotikëve/prekursorëve të paligjshëm, ruajtja e të cilëve përbën rrezik për sigurinë, shëndetin ose higjienën publike (2025). Miratimi i akteve nënligjore të kërkuara për kriteret dhe procedurat e verifikimit të integritetit, në lidhje me personelin e Agjencisë Kombëtare të Kanabisit dhe subjektet private të licencuara për prodhimin e kanabisit për qëllime mjekësore dhe industriale.	Ngritja e një sistemi kombëtar të paralajmërimit të hershëm për shkëmbimin e informacionit për substancat e reja psikoaktive deri në vitin 2025 dhe një observator kombëtar të drogës deri në vitin 2026. Forcimi i kapaciteteve të njësive të specializuara për luftën kundër drogës përmes trajnimeve dhe pajisjes së tyre me mjete dhe mjete adekuate (në vazhdimësi). Rritja e kapaciteteve të njësive së sapokrijuar për Administrimin e Provave Materiale, duke përfshirë mbështetjen logjistike për asgjësimin e narkotikëve të paligjshëm dhe prekursorëve (2024). Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të masave të verifikimit të integritetit të zbatueshme për stafin e Agjencisë Kombëtare të Kanabisit dhe subjektet private të licencuara.	Krijimi dhe funksionalizimi i Observatorit Kombëtar të Drogave dhe Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm Kuadri ligjor, duke përfshirë udhëzimet/protokollet e përmirësuar në bazë të bashkëpunimit me EMCDDA. Përmirësimi i standardeve të ruajtjes dhe asgjësimit të provave materiale të lëndëve narkotike. Të dhëna të qëndrueshme të konfiskimeve dhe shkatërrimit të drogës. Bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe proaktiv me Europolin dhe agjencitë e zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare të BE-së dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor në luftën kundër trafikut të drogës.
LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT			
VI. Legjislacioni është përafruar dhe zbatuar në mënyrë efektive me kapacitetin e duhur, duke përfshirë. VI.1 Përmbajtjen terroriste në internet (monitorimin dhe heqjen e përmbajtjes <i>online</i>). VI.2 Legjislacioni është përafruar dhe zbatuar në mënyrë efektive me kapacitet adekuat për sa i përket përdorimit të prekursorëve shpërthyes. VI.1.3 Legjislacioni është përafruar dhe	Sigurimi i zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit dhe Planet e Veprimit 2022–2025, duke përfshirë rinovimin dhe ndjekjen e tyre. Sigurimi i ndryshimeve të mëtejshme legjislative në lidhje me terrorizmin, në përputhje të plotë me instrumentet përkatëse të BE-së, duke përfshirë përkufizimet dhe kriminalizimin e veprimeve të caktuara, të tilla si ndërhyrja e paligjshme e të dhënave, përmbajtja terroriste në internet dhe ndihma dhe mbështetja për viktimat e terrorizmit deri në vitin	Sigurimi i burimeve të nevojshme, përmes mbështetjes së vazhdueshme teknike dhe logjistike për strukturat kundër terrorizmit, duke përfshirë një menaxhim më të mirë të çështjeve dhe mekanizëm referimi. Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm. Ofrimi i trajnimeve për adresimin e përmbajtjes terroriste në internet përmes përdorimit të aftësive të Qendrës Evropiane kundër Terrorizmit të Europolit dhe vazhdimi i bashkëpunimit me Njësinë e Referimit të Internetit të Europolit (2024).	Kuadri ligjor i harmonizuar në përputhje me instrumentet e BE-së deri në vitin 2026. Qasje e kontrolluar në prekursorët shpërthyes, të cilët mund të përdoren për vepra që lidhen me qëllime terroriste. Plani i Përbashkët i Veprimit Kundër Terrorizmit dhe marrëveshja zbatuese dypalëshe kryesisht është zbatuar. Marrëveshja e re e nënshkruar në dhjetor 2022 është në zbatim. T'i jepet përparësi mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe zvogëlimit të cenueshmërisë së sulmeve, por

zbatuar në mënyrë efektive me kapacitete adekuate, në lidhje me infrastrukturën kritike, dhe mbrojtjen/rezistencën e subjekteve kritike.	2026. Hartimi dhe miratimi i PSV-ve për të identifikuar, zbuluar, analizuar dhe bllokuar përmbajtjen terroriste në internet në bashkëpunim me strukturën e krimin kibernetik (2026). Miratimi dhe zbatimi i ligjit të ri për prekursorët shpërthyes, në përputhje me Rregulloren e BE-së (2025) dhe krijimi i një mekanizmi efektiv për raportimin e transaksioneve të dyshimta. Rishikimi i kuadrit ligjor për qëndrueshmërinë e subjekteve kritike deri në vitin 2026.	Ofrimi periodik i një vlerësim i përbashkët kombëtar për kërcënimin mbi terrorizmin, sipas Marrëveshjes së rishikuar me Shqipërinë për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor (2024 e në vazhdim). Konsolidimi i kapaciteteve njerëzore për identifikimin e infrastrukturës kritike dhe përcaktimin si Infrastrukturë Kritike Evropiane, hartimin e kriterëve dhe ofrimin e udhëzimeve për menaxhimin e tyre, duke përfshirë analizën e rrezikut, rishikimin e planeve të sigursë dhe mbrojtjes, rolet dhe përgjegjësitë. Kryerja e takimeve dhe iniciativave ndërgjegjësuere me palët e interesuara si ofruesit e shërbimeve të internetit, platformat e medieve sociale dhe publikun, në lidhje me legjislacionin e ri dhe masat e nevojshme për respektimin e tij. Miratimi i ligjit për prekursorët shpërthyes pasohet nga: - krijimi i autoriteteve kompetente kombëtare të kërkuara (duke përfshirë një pikë kontakti kombëtare 24/7); - kufizime të zbatuara në mënyrë efektive në shitjet për anëtarët e publikut të gjerë (të disa prekursorëve shpërthyes); - një mekanizëm efektiv për raportimin e transaksioneve të dyshimta; - forcimi i vazhdueshëm i ndërgjegjësit, trajnimit dhe bashkëpunimi i sektorit publik-privat. Krijimi i procedurave të përshtatshme të brendshme administrative dhe përmirësimi i njohurive dhe menaxhimit të informacionit në Qendrën Koordinuese Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE). Sigurimi i vazhdueshëm i financimit të aktiviteteve kundër terrorizmit dhe aktiviteteve të CVE-së.	gjithashtu të sigurohet rezistenca e subjekteve që operojnë atë infrastrukturë (p.sh. sigurimi i kufijve të jashtëm; përmirësimi i sigurisë së transportit; mbrojtja e objektivave strategjikë; dhe zvogëlimi i cenueshmërisë së infrastrukturës kritike) është vendosur deri në vitin 2026. Platformat, produktet, shërbimet dhe aftësitë e komunikimit të Qendrës Evropiane Kundër Terrorizmit të Europolit përdoren sistematikisht. Përpjekjet për riintegrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve nga Siria, dhe për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të të dyshuarve për vepra penale të lidhura me terrorizmin do të vazhdojnë (2024 e në vazhdim). Zbatimi efektiv i sanksioneve financiare të synuara të mandatuara nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, ndër të tjera duke rritur përfshirjen e institucioneve financiare dhe aktorëve të tjerë përkatës dhe nëpërmjet inspektimeve efektive.
BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJE PENALE DHE CIVILE			
Vendi është në gjendje të sigurojë bashkëpunim efikas në çështjet civile dhe penale me shtetet anëtare si dhe me agjencitë dhe organet e BE-së.	Përafrimi i kuadrit ligjor, duke përfshirë Kodin e Procedurës Penale me <i>acquis</i> përkatëse të BE-së për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, duke përfshirë legjislacionin për ndihmën e ndërsjellë juridike, zbatimin e drejtpërdrejtë pa procedurë njohjeje dhe vendosjen e lidhjes së drejtpërdrejtë me sistemet e informacionit të dosjeve penale të shteteve të tjera deri në vitin 2026. Përafrimi i sistemit ligjor shqiptar me <i>acquis</i> të BE-së për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet civile, në lidhje me marrjen e provave dhe dorëzimin e dokumenteve, njohjen e gjyqësorëve të huaja, masat për rrëmbimin e fëmijëve, mbështetjen e fëmijëve, ekzekutimin e urdhrave të gjykatave të huaja për mirëmbajtjen dhe urdhrat për mbrojtjen e fëmijës dhe falimentimin në kuadër të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në çështjet civile, tregtare dhe familjare, pa <i>ekzekutaturë</i>, në njohje dhe ekzekutim të drejtpërdrejtë (Kodi i Procedurës Civile)	Kapacitetet e duhura profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, përmbarduesve, shërbimeve sociale, njësisë policore përgjegjëse për çështjet e fëmijëve dhe stafit të Ministrisë së Drejtësisë përgjegjëse për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet civile dhe penale për të siguruar përmirësimin bazuar në projeksionet vjetore që nga viti 2026 e në vazhdim. Menaxhimi i kapaciteteve operacionale dhe i prokurorisë dhe gjykatave të mbështetura në kuadrin e veprimeve të lidhura me reformën në drejtësi, sipas kap. 23 për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit për të drejtën ndërkombëtare penale dhe civile. (<i>Shihni nënkapitullin e gjyqësorit nën kapitullin 23.</i>) Ruajtja e nivelit të lartë të bashkëpunimit efektiv me Eurojustin, Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO), Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Të sigurohet bashkëpunim efektiv me Eurojustin, EPPO-në dhe OLAF-in në të gjitha rrethanat, duke përfshirë dy nivele: i. bashkëpunim aktiv duke përfshirë raportimin e çdo sjellje	Bashkëpunimi gjyqësor si në çështjet e së drejtës penale, ashtu edhe në ato civile kryhet në kohë dhe në mënyrë efikase bazuar në legjislacionin e përafëruar dhe ngritjen e strukturave të duhura institucionale deri në vitin 2030. Përmirësimi i efikasitetit të procedurave që përfshijnë një element ndërkufitar, duke përfshirë digjitalizimin dhe efikasitetin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja, si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale deri në vitin 2030. Shqipëria ruan gjithnjë e më shumë pozicionin e saj si një partner i besueshëm i Eurojustit, EPPO-së dhe OLAF-it duke forcuar bashkëpunimin e saj me këto autoritete përmes kapaciteteve të zgjeruara deri në vitin 2030. Bashkëpunimi operativ me EPPO-në u nxit në përputhje me marrëveshjet e punës në fuqi, duke

	deri në vitin 2026. Finalizimi i procedurave për t'u bërë palë në Konventën e Hagës për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës, Protokollin mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet e Mirëmbajtjes, Protokollin për ndryshimin e Protokollit Shtesë të Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar (CETS Nr. 222), Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës për krimin kibernetik për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike (CETS nr. 224), Protokollin që ndryshon Konventën Evropiane për Shtypjen e Terrorizmit (ETS nr. 190), Konventën për Mbrojtjen e Mjedisit përmes së Drejtës Penale (ETS nr. 172 (është nënshkruar, por e nuk është ratifikuar), Konventën e Hagës për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës, Protokollin mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet e Mirëmbajtjes, Konventën mbi Marrëveshjet për Zgjidhjen Ndërkombëtare që rezultojnë nga Ndërmjetësimi dhe Konventën për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve Gjyqësore të Huaja në Çështjet Civile ose Tregtare deri në vitin 2027.	kriminale, të paligjshme ose parregullsi që mund të përfshihet në mandatin e tyre përkatës; dhe ii. bashkëpunim i mëvonshëm përmes MLA-së dhe kuadrit tjetër përkatës ligjor, duke përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare dhe shumëpalëshe dhe marrëveshjet e punës dhe marrëveshjet e miratuara të punë. Bashkëpunimi operacional me EPPO-në përfshin, por nuk kufizohet në: i. ofrimin një bashkëpunimi në shkallë sa më të gjerë për mbledhjen e provave; ii. bashkëpunimin në fushën e ngritjes së aseteve, në përputhje me instrumentet e aplikueshme shumëpalëshe, duke përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe për financimin e terrorizmit (Konventa e Varshavës e 2005); iii. ngritjen e ekipeve të përbashkëta hetimore sa herë që është e nevojshme, në lidhje me çështjet që janë në juridiksionin e EPPO-së; dhe iv. ekstradimin kur kërkohet nga EPPO-ja, në përputhje me instrumentet përkatëse shumëpalëshe, në lidhje me këtë, siç është Konventa Evropiane për Ekstradimin (Paris 1957) dhe protokollet e saj shtesë. Sigurimi i bashkëpunimit efektiv me Eurojustin dhe OLAF-in në përputhje me mandatin e tyre përkatës. Sigurimi i bashkëpunimit proaktiv, duke përfshirë raportimin dhe veprimet e përgjegjshme. Përmirësimi i kapaciteteve të shërbimit të ndërmjetësimit. Digjitalizimi i drejtësisë sigurohet nga legjislacioni përkatës i TI-së dhe infrastrukturës. Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve përmes ofrimit të trajnimeve për stafin në burgje dhe shërbimet e provës.	përfshirë dërgimin e oficerit/oficerëve ndërlidhës në selinë e EPPO-së në Luksemburg, kur këtë e justifikojnë nevojat operative.
MIGRACIONI, AZILI, VIZAT			
1. Kuadri i përgjithshëm VIII.1.1 Vendi zbaton një sërë rregullash dhe standardesh të përbashkëta për migracionin e ligjshëm dhe për luftën kundër migracionit të parregullt, si dhe rregullat për çështjet e azilit. VIII.1.2 Ka aftësinë për të përpunuar kërkesat për azil në mënyrë efektive dhe në kohë. VIII.1.3 Kuadri strategjik dhe legjislacioni janë përafër dhe zbatuar në mënyrë efektive me kapacitetin e duhur, në lidhje me të huajt që hyjnë/qëndrojnë brenda territorit	Miratimi në vitin 2024 i Strategjisë së re për Migracionin 2024–2030 dhe Planet e Veprimit të lidhura me të 2024–2026 dhe 2027–2030. Ndryshimi i ligjit për të huajt, në lidhje me përkufizimin e “Shtetasve të vendeve të treta” dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për të huajt”, nr. 79/2021, deri në vitin 2025 Miratimi i një plani të detajuar – duke përfshirë koston – për të rritur kapacitetin aktual të pritjes dhe për të përmbushur më mirë nevojat e të miturve të pashoqëruar dhe grupeve vulnerabël	Përmirësimi i mëtejshëm i mekanizmave të krijuar për koordinimin e qeverisjes së migracionit. Krijimi i strukturave të përhershme të trajnimit, në përputhje me standardet bazë të trajnimit për rojet kufitare të BE-së, në kuadër të PSHSH-së. Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme të Policisë Kufitare dhe Migracionit, në veçanti oficerëve të trajnuar për të identifikuar refugjatët dhe migrantët me nevoja specifike.	Politikë solide dhe kuadër ligjor i përmirësuar në përputhje me <i>acquis</i> dhe praktikat më të mira të BE-së, duke mundësuar një sërë rregullash të duhura për migracionin.

kombëtar ligjërisht ose në mënyrë të parregullt. VIII.1.4 Ka sisteme të TI-së në dispozicion që merren me kërkesat/dokumentet zyrtare përkatëse.			
MIGRACIONI I RREGULLT			
VIII.2.1 Legjislacioni është përfunduar dhe zbatuar në mënyrë efektive me kapacitetin adekuat të zbatuar, në lidhje me migracionin legal, duke përfshirë në mënyrë të veçantë bashkimin familjar, Kartën Blu të BE-së, lejen e vetme.	Miratimi deri në vitin 2024 i Strategjisë së re për Migracionin 2024-2030 dhe Planet e Veprimit plotësues që sigurojnë përputhjen me objektivat e Strategjisë për kthimin dhe riintegrimin vullnetar, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e një politike të qeverisjes së migracionit të përfunduar me Paktin Global për Migracionin dhe Paktin Global të Refugjatëve. Përafrimi i legjislacionit për të huajt me <i>acquis</i> të BE-së për kartonin blu, lejen e vetme, bashkimin familjar, hyrjen e punëtorëve me kualifikim të lartë, punëtorët sezonalë dhe dërgimin e punëtorëve, në kuadër të ofrimit të shërbimeve – 2030); <i>Rrjetit Evropian të Migracionit</i> (2024); dhe punësimin me kualifikim të lartë (2025). Miratimi i programeve të dedikuara integruese, të harmonizuara me Planin e Veprimit të BE-së për Integrim dhe Përfshirje 2021–2027 (2025).	Strategjia e Re e Migracionit 2024-2030 parashikon mekanizma të përmirësuar për koordinimin e qeverisjes së migracionit duke përfshirë ndërveprimin më të mirë me pushtetin vendor për çështjet e migracionit, intensifikimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare, përfshirjen më të madhe të institucioneve të pavarura, përfshirë Avokatin e Popullit, etj.). Zbatimi i plotë i ndryshimeve në regjistrin elektronik për të huajt, për aplikimin <i>online</i> të shtetasve të huaj për një leje unike dhe pasqyrimin e ndryshimeve ligjore në sistem (deri në vitin 2025). Përshtatja e shërbimeve të punësimit dhe programet e nxitjes së punësimit, duke përfshirë ofrimin e kurseve të gjuhës shqipe për emigrantët (2025–2030). Rritja në mënyrë progresive e personelit të përgjithshëm të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit të PSHSH-së. Formalizimi dhe forcimi i sporteleve të migracionit në 61 bashki për të lehtësuar riintegrimin deri në vitin 2026. Vazhdimi i trajnimit të oficerëve të policisë për t'u trajnuar për shoqërimin e të kthyerve në Shqipëri. Rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të Policisë Kufitare dhe Migracionit për të identifikuar refugjatët dhe migrantët me nevoja specifike. Forcimi i bashkëpunimit me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare/Rrjetin Evropian të Kthimit dhe Riintegrit; të vihet në dispozicion një kuadër cilësor për ofruesit e shërbimeve të riintegrit bazuar në standardet e BE-së (2025). Shkëmbimi rregullisht i informacionit dhe praktikave më të mira me vendet e BE-së. Përmirësimi i sistemeve <i>online</i> për krijimin e lehtësive në aplikim dhe akses të drejtpërdrejtë në tregun e punës. Promovimi i migracionit të rregullt dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare (2029).	Akses më i madh i shtetasve të huaj, veçanërisht i atyre me kualifikime të larta për të mundësuar hyrjen e tyre në tregun e punës në Shqipëri, duke përfshirë mundësi të barabarta punësimi nëpërmjet sistemeve <i>online</i>; Riintegrimi i suksesshëm i të kthyerve, veçanërisht i atyre që janë më vulnerabël. Adresimi efektiv dhe reduktimi i të miturve të pashoqëruar që udhëtojnë nga Shqipëria drejt vendeve anëtare të BE-së. Rritje progresive deri në 10% e personelit të përgjithshëm aktual të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit të PSHH-së.
MIGRACIONI I PARREGULLT			
VIII.3.1 Ekziston një kuadër strategjik për të luftuar migraconin e parregullt, duke përfshirë kontrabandën e migrantëve. VIII.3.2 Legjislacioni për standardet dhe procedurat e përbashkëta për kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të paligjshëm janë përfunduar dhe zbatuar në mënyrë efektive.	Miratimi deri në vitin 2024 I Strategjisë së re për migracionin 2024–2030 dhe Planet e Veprimit plotësues të saj, në përputhje me objektivat e Strategjisë së BE-së për kthimin dhe riintegrimin vullnetar. Sigurimi i përafrimit të ligjit për të huajt me <i>acquis</i> përkatëse deri në vitin 2025; Nënshkrimi i marrëveshjeve të ripranimit (marrëveshjet, protokollet, marrëveshjet e përbashkëta) me vendet e origjinës për periudhën 2025–2029; Përditësimi periodik i planit të kontigjencës për një numër	Përmirësimi i kapaciteteve përmes trajnimeve, seminareve dhe workshopeve, lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor dhe procedural me pjesëmarrjen e palëve të interesuara për periudhën 2023–2025; Forcimi i bashkëpunimit me Agjencinë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare. Forcimi i bashkëpunimit me Europolin dhe Qendrën e tij Evropiane të Kontrabandës së Migrantëve (EMSC), veçanërisht me pjesëmarrjen aktive në prioritetin e ciklit të EMPACT 2022-	Kthime efikase dhe efektive, duke përfshirë kthimet vullnetare. Kthimi i migrantëve sigurohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedural kombëtar dhe ndërkombëtar. Operacionet e kthimit dhe pjesëmarrja në operacionet e përbashkëta të kthimit të organizohen në përputhje me standardet e komunitetit në fushën e kthimit.

VIII.3.3 Marrëveshjet e ripranimit janë në fuqi dhe zbatohen në mënyrë efektive. VIII.3.4 Kapaciteti zbatues është i mjaftueshëm (përfshirë organizimin e fluturimeve të përbashkëta për largimin e shtetasve të vendeve të treta që janë subjekt i urdhrave individuale të largimit). VIII.3.5 Kapacitetet pritëse, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta, janë adekuate dhe në përputhje me standardet.	të konsiderueshëm migrantësh dhe azilkërkuesish që mund të vijnë me shpërndarje të përshtatshme buxhetore dhe modalitete të qarta aktivizimi deri në vitin 2025.	2025 për kontrabandën e migrantëve. Mbështetja e zbatimit të Partneritetit Operacional kundër Kontrabandës Rajonale me Ballkanin Perëndimor. Ngritja deri në vitin 2025 e një Moduli Digital për Sistemin e Menaxhimit të Rasteve të Ripranimit (RCMS), për periudhën 2023-2025; Ngritja e ambienteve të veçanta për të miturit e pashoqëruar dhe përmirësimi i koordinimit me departamentet e mbrojtjes së fëmijëve dhe antitrafikimit brenda vitit 2027. Ngritja e Qendrës së Pritjes së Përkohshme të Emigrantëve në PKK Qafë-Botë (përfshirë kategoritë vulnerabël) 2023–2025; Kompletimi i qendrave pritëse me staf profesional si mjekë, dentistë, përkthyes në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit brenda periudhës 2025–2029.	Nivelet e duhura të mbrojtjes që u ofrohen fëmijëve dhe të miturve të pashoqëruar.
AZILI			
VIII.4.1 Legjislacioni dhe procedurat në fushën e azilit janë përafër dhe zbatuar në mënyrë efektive. VIII.4.2 Kapacitetet pritëse, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta janë adekuate dhe në përputhje me standardet. VIII.4.3 Është hartuar. Plani i emergjencës në rast të një fluksi masiv të azilkërkuesve	Përafrimi i ligjit për azilin me 5 ¹ direktivat e Bashkimit Evropian brenda periudhës 2025–2030. Miratimi i një plani kontigjence në mënyrë që të përgatitemi për një situatë me fluks masiv të azilkërkuesve deri në vitin 2025.	Sigurimi i trajnimit të nevojshëm për Drejtorinë për Azilin dhe Shtetësinë për të vlerësuar kërkesat individuale, veçanërisht informacionin mbi vendin e origjinës dhe rastet që përfshijnë persona vulnerabël, për të mbrojtur informacionin sensitiv, duke përfshirë modulet <i>online</i> nga EUAA-ja. Forcimi i kapaciteteve profesionale të Qendrës së Pritjes për Azilin për ofrimin e shërbimeve për individët/grupet vulnerabël. Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për të trajtuar flukset e azilkërkuesve nëpërmjet mbështetjes dhe shërbimeve të drejtpërdrejta të qeverisë për të gjitha kategoritë e azilkërkuesve. Rritja e numrit të përkthyesve të kualifikuar në qendrat e pritjes së përkohshme gjatë dhe pas procesit të shqyrtimit paraprak, si dhe inkurajimi i përkthyesve femra që të rrisin raportimin për dhunën dhe për rastet e mundshme të trafikimit. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për sigurimin e kapaciteteve të përshtatshme, sipas fushës së përgjegjësisë për trajtimin e një fluksi të mundshëm azilkërkuesish në vend.	Rritja e efikasitetit dhe e zbatimit cilësor të ligjit për azilin, duke përfshirë edhe kapacitetet administrative shtesë. Sigurimi i kapaciteteve adekuate pritëse për azilkërkuesit. Standarde të përshtatshme dhe kushte pritjeje për të gjithë aplikantët e mbrojtjes ndërkombëtare, veçanërisht të miturit e pashoqëruar, të moshuarit, gratë shtatzëna, gratë beqare, personat me aftësi të ndryshme etj.)
POLITIKA E VIZAVE			
VIII.5.1 Vendi ka politikën e tij në përputhje me standardet e përbashkëta, duke përfshirë listën e vendeve të treta, shtetasit e të cilëve duhet të kenë vizë kur kalojnë kufijtë e jashtëm të BE-së.	Sigurimi i harmonizimit sa më të plotë me Rregulloren (BE) 2018/1806 deri në vitin 2030. Ndryshimi i ligjit për të huajt për të përfshirë mbledhjen e të dhënave të gjurmëve të gishtërinjve për të qenë në përputhje me kërkesat e EURODAC-it	Miratimi i marrëveshjeve me vendet nga të cilat shtetasit mund të hyjnë në BE pa vizë, por janë nën detyrimin për vizë në Republikën e Shqipërisë (2023–2025). Kryerja e një vlerësimi periodik të situatës dhe rreziqeve të abuzimit me regjimin pa vizë për shtetasit e vendeve të treta të cilëve u kërkohet vizë për të hyrë në BE, bazuar në të dhënat	Përafrimi sa më i plotë me politikën e vizave të BE-së. Kërkesat e pabazuara për azil nga shtetasit shqiptarë brenda BE-së trajtohen në mënyrë efektive. - Lidhur me kërkesat për azil nga shtetasit shqiptarë

¹ 1. Direktiva e Këshillit 2001/55/KE e 20 korrikut 2001, mbi standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e një fluksi masiv të personave të zhvendosur (2025-2030). 2. Direktiva e Këshillit 2013/32/KE e 1 dhjetorit 2005, mbi standardet minimale mbi procedurat e Shteteve Anëtare për dhënien dhe tërheqjen e statusit të refugjatit (2025-2030). 3. Direktiva e Këshillit 2013/33/KE e 27 janarit 2003, që përcakton standardet minimale për pritjen e azilkërkuesve (2025-2030). 4. Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011, mbi standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta (2025-2030). 5. Direktiva e Këshillit 2003/86/EC e datës 22 shtator 2003 mbi të drejtën për bashkim familjar (2025–2030).

VIII.5.2 Legjislacioni dhe procedurat janë të harmonizuara me politikën e <i>acquis</i> të BE-së dhe zbatohen në mënyrë efektive me kapacitetin e duhur.	(2025–2029).	kombëtare, si dhe informacionin e dhënë nga Frontex dhe autoritetet e Shteteve Anëtare të BE*-së. Ndërprerja në mënyrë graduale e regjimeve pa viza me vendet, qytetarët e të cilave u kërkohet viza në BE për mekanizmin e zbatuar gjatë sezonit turistik (2030). MEPJ-ja do të nisë një vlerësim të brendshëm për nevojën e rritjes së kapaciteteve dhe infrastrukturës që përfshin nevojën për marrjen e të dhënave biometrike në Misionet Diplomatie dhe Konsullore Shqiptare (2023–2025). Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, MEPJ-ja do të fillojë rritjen e kapaciteteve (pajisjet dhe softuerin sipas standardeve të BE-së dhe ICAO), për marrjen e të dhënave biometrike dhe të gjurmëve të gishtërinjve për të huajt që udhëtojnë me vizë (2025–2030). Integrimi dhe ndërveprimi i plotë i sistemit <i>e-Visa</i> me TIMS dhe FER (Regjistri Elektronik i Huaj) dhe <i>e-Albania.al</i> për të gjitha proceset e vizave. Ndërveprueshmëria e plotë do të arrihet deri në vitin 2026.	në BE, RSH, në bashkëpunim të ngushtë me IOM-in po përfundon draftin përfundimtar të Strategjisë Kombëtare për Migracionin. - Forcimi i kontrollit të daljes së shtetasve shqiptarë, qëllimi i të cilëve është arritja në vendet e BE-së. - Zbatimi i marrëveshjes së ripranimit me BE. - Forcimi i bashkëpunimit me Korpusin e Përhershëm të Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane të dislokuar nga Frontex në PKK-të kryesore në kufi me vendet e BE-së, veçanërisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së re të Statusit me Frontex. - Masa sensibilizuese me informacion për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve shqiptarë gjatë lëvizjes së lirë në zonën Schengen.
SCHENGEN DHE KUFIJTË E JASHTËM			
VIII.1. Vendi është në gjendje të sigurojë menaxhimin, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e duhur të kufijve të jashtëm të BE-së dhe të bashkëpunojë në mënyrë efektive me Shtetet Anëtare, organet e BE-së dhe vendet fqinje VIII.2 Vendi është i gatshëm të zbatojë plotësisht kufijtë e jashtëm të kërkuar dhe <i>acquis</i> përkatëse të Shengenit pas anëtarësimit. VIII.3 Në veçanti, është përafëruar dhe zbatuar në mënyrë efektive legjislacioni përkatës në lidhje me: menaxhimin e kufirit (përfshirë kapacitetin e policisë kufitare), sistemin e hyrje-daljes, komunikimin e të dhënave të pasagjerëve dhe kodin kufitar Shengen. VIII.4 Masat për të luftuar korrupsionin në kufij janë miratuar dhe zbatuar në mënyrë efektive.	Përafrimi i mëtejshëm i Ligjit për Kontrollin Kufitar me Kodin Kufitar të Shengenit dhe kërkesat e Regjistrimit të Emrit të Pasagjerit (PNR) deri në vitin 2026. Miratimi i legjislacionit për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të MIK deri në vitin 2027 Krijimi i një <i>Qendër Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit</i>, në përputhje me Rregulloren EUROSUR deri në vitin 2028. Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve dhe i protokolleve me vendet fqinje për periudhën 2025–2029. Miratimi i Planit të Veprimit për MIK 2024–2027 në përputhje me Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027. Zhvillimi dhe përmirësimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV), për t'u përafëruar me standardet kufitare të Shengenit. Miratimi dhe zbatimi deri në vitin 2024 i ndryshimeve strukturore për ngritjen e strukturave të hetimit.	Vazhdimi i forcimit të burimeve logjistike në përputhje me Katalogun Schengen brenda vitit 2030. Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve e burimeve njerëzore, veçanërisht për mbikëqyrjen e kufirit dhe të ndërmerren aktivitetet për të parandaluar qarkullimin e lartë të stafit në Policinë Kufitare. Forcimi i mëtejshëm i autonomisë operacionale dhe menaxheriale të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Realizimi i trajnimeve, seminareve, <i>workshop</i>-eve në lidhje me zbatimin e kuadrit ligjor dhe procedural me pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar për periudhën 2024–2025. Rritja e kapaciteteve në kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit për periudhën 2024–2025. Përmirësimi i Sistemeve Digjitale të Informacionit në përdorim nga strukturat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit. Krijimi i strukturave të hetimit të krimit ndërkufitar në Policinë Kufitare në nivel qendror dhe rajonal dhe forcimi i kapaciteteve të tyre profesionale për të përballuar çështjet që lidhen me korrupsionin.	Ulja e cenueshmërisë në kufi, duke reaguuar në mënyrë më efektive me vendosjen e burimeve në dispozicion, bazuar në analizën e kryer të rrezikut dhe kërcënimit që mund të ndikojë në sigurinë kufitare, në përputhje me modelin CIRAM të BE-së. Krijimi i pikave të përbashkëta të kalimit kufitar me vendet fqinje. Përmirësimi i parandalimit dhe i zbulimit të veprave penale ndërkufitare, për shkak të rritjes së aksesit në bazat e të dhënave për zbatimin e ligjit dhe fuqizimi i policisë kufitare me kapacitete hetimore dhe logjistike.
FALSIFIKIMI I EUROS			
Vendi ka kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar rregullat e përbashkëta	Sigurimi i përafrimit të duhur me direktivën 2014/62/BE përmes ndryshimeve në kuadrin legjislativ deri në vitin	Krijimi i Zyrës Qendrore Kombëtare për falsifikimin e monedhave në Policinë e Shtetit (2024).	Rritja e zbatimit në praktikë të rregullave të përbashkëta për të mbrojtur euron dhe monedhat e

për të mbrojtur euron dhe monedhat e tjera nga falsifikimi.	2026.	Përmirësimi i procedurave të centralizimit të analizës dhe të klasifikimit të monedhave të falsifikuara dhe të dhënave teknike, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Falsifikimin e Monedhave ndërmjet Ministrisë së Brendshme (Policisë së Shtetit), Bankës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Të vazhdohet më tej shkëmbimi i informacionit me DG/ECFIN (ETSC), Europol dhe Bankën Qendrore Evropiane (BQE), sipas marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit për mbrojtjen e monedhës euro nga falsifikimi.	tjera nga falsifikimi.
---	-------	--	------------------------